



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 57/2020 regjistër (JR)
Datë 07.12.2020

Nr. 6 i vendimit
Datë 22.02.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.02.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 57/2020, datë 07.12.2020, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 289, datë 06.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 e F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 62 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet para seancës, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj Lindita Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Shkodër. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;
- ka mosdeklarim të të ardhurave të bashkëshortit dhe të likuiditeteve në bankë;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin², në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha.

2.3 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë, përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.06.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendim të KZhd-së nr. {***}, datë 24.04.2019, përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2019.

³ Raporti i KLGj-së për analizimin e aftësisë profesionale nr. {***} prot., datë 16.04.2019.

pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 289, datë 06.08.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 289, datë 06.08.2020, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër [...]”. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë.

4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

*Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim, në përputhje me pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Në vlerësim të rrethanave lidhur me konfliktin në dukje të interesit, në shqyrtimin e çështjeve me shoqërinë “{***}” ShA, subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të shkronjës “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), më datë 06.11.2020, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 289, datë 06.08.2020, të Komisionit. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) konfirmimin në detyrë dhe në mënyrë alternative gjykimin në fakt të çështjes, duke riçelur hetimin gjyqësor për marrjen në cilësinë e provës të akteve që i bashkëngjiten ankimit. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre, kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të administruara nga Komisioni.
6. Shkaqet e ankimit që i përkasin natyrës procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, janë si vijojnë.
- 6.1 Vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një gjykimi të njëanshëm, subjektiv dhe të pabazuar në prova, pasi, sipas parashikimeve kushtetuese e ligjore, Komisioni është jo vetëm një organ vlerësues e gjykues, por edhe një lloj “akuzuesi” për shkeljet që ka konstatuar, duke qenë në njëfarë kuptimi edhe palë në këtë proces.
- 6.2 Seanca dëgjimore dhe shpallja e vendimit kanë ndodhur kur subjekti i rivlerësimit ishte duke kryer lejen e zakonshme vjetore të magjistratit, në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës.
- 6.3 Vendimi i Komisionit ka karakterin e një dënimi penal dhe është me fuqi prapavepruese.

6.4 Komisioni, për raste me problematika të ngjashme me ato të konstatuara për subjektin e rivlerësimit, ka bërë zgjidhje ligjore të ndryshme, duke mbajtur standard të dyfishtë.

6.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet përpara zbatimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që legjitimon shkarkimin nga detyra, pasi mungon kushti kumulativ, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit mund të shkarkohet vetëm nëse ka bërë njëkohësisht deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë dhe figurës.

6.6 Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra e dhënë nga Komisioni, është një masë ndëshkimore tepër e rëndë, e cila nuk është në proporcion me pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1 Konkluzionet e Komisionit për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 92 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër”, janë të pabazuara, pasi subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të hollësishme dhe ka paraqitur prova se kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme.

7.2 Është i pavërtetë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi deklaroi se zotëron pjesë takuese në pasurinë tokë arë me sipërfaqe 19,500 m², por nuk ka deklaruar pjesën takuese që ka mbi ndërtesën e ndërtuar në të.

7.3 Për sa i përket ndërtimit informal në fshatin {***}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë atë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe ka pasur burime të mjaftueshme për të ndërtuar këtë objekt.

7.4 Konkluzioni i Komisionit se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga qiraja derdhur nga shoqëria “{***}” ShA, në periudhën 2008-2012, është një konkluzion i qëllimshëm dhe një përpjekje për të keqinterpretuar provat në justifikim të një vendimi të pabazuar.

7.5 Sa i përket gjykimit dhe dhënies së vendimeve me nr. {***}, datë 28.05.2008, vendimit nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe vendimit nr. {***}, datë 24.03.2014, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk ka konstatuar shkaqe për të cilat duhej të jepte dorëheqjen nga gjykimi i këtyre çështjeve sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk ka konstatuar gjithashtu as qëndrime të njëanshme apo favorizuese për shoqërinë “{***}” ShA.

7.6 Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 64,35 m² në {***}, Lezhë, nga Komisioni nuk është bërë një analizë e qartë e burimeve financiare të deklaruara dhe të përdorura nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie.

7.7 Për pasurinë automjet, tip “Benz 270 C Class”, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mundësinë financiare të huadhënësve për të dhënë shumat përkatëse dhe nuk shpjegon mënyrën e marrjes së tyre, në muajin kur është blerë automjeti, është i pabazuar.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 289, datë 06.08.2020, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në dhomë këshillimi, në përputhje

me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).

9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, konstaton se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, si dhe vendos për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.
10. Me ankimin dhe parashtrimet para seancës⁴, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte në cilësinë e provave të reja, për të cilat trupi gjykues vlerësoi se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012⁵, i ndryshuar, duke refuzuar marrjen e tyre, bazuar në nenin 49, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016⁶, me arsyetimin si më poshtë.

10.1 Për aktet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme për pasurinë arë+truall me sipërfaqe 3.102 m², nga kjo 202 m² truall, nga kjo 120 m² ndërtesë, në pronësi të R. J. J., me nr. pasurie {***}, në ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, Shkodër, {***}; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme për pasurinë arë me sipërfaqe 19.500 m², në pronësi të R. J. J., me nr. pasurie {***}, në ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, Shkodër, {***}; (iii) vendim nr. {***}, datë 16.05.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerëve R. e Q. J., duke përcaktuar si trashëgimtar ligjor djalin e tyre Xh. J.; (iv) vërtetim nr. {***}, datë 28.01.2020 i lëshuar nga shkolla e mesme jopublike “{***}”, sipas të cilit nxënësja E. B. J. ka qenë nxënëse në këtë shkollë, gjatë viteve 2016-2019; (v) Vërtetim nr. {***}, datë 28.01.2020, i lëshuar nga shkolla e mesme jopublike “{***}”, sipas të cilit nxënësi E. B. J. ndjek mësimet në këtë shkollë, gjatë vitit 2019-2020; (vi) vërtetim nr. {***}, datë 28.01.2020, i lëshuar nga shkolla e mesme jopublike “{***}”, sipas të cilit nxënësja E. B. J. ndjek mësimet në këtë shkollë, gjatë vitit 2019-2020 – trupi gjykues konstatoi se janë akte të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe referojnë fakte të njohura nga Komisioni. Për këto arsye, këto akte përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre në zgjidhjen e çështjes dhe refuzohen të merren si prova, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

10.2 Për sa u përket akteve: (i) të dhëna nga sistemi federal i taksave për z. R. J. dhe znj. V. S., nga shteti i Nju Jork-ut, për vitet 2008, 2009, 2010; (ii) akt ekspertimi, punuar nga ing. B. Sh., për llogaritjen e vlerës së ndërtimit të objektit stallë për rritje shpendësh, ndodhur në fshatin {***}; (iii) shkresë e “{***}” ShA me nr. {***} prot., datë 24.10.2014, drejtuar z. G. A., me lëndë: “Njoftim për mosrinovimin e kontratës së qirasë me nr. {***}, datë 30.06.2014; (iv) kartelë e pasurisë së paluajtshme për pasurinë “Arë” me sipërfaqe 6.000 m², me nr. pasurie {***}, në ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, në {***}, Shkodër, në pronësi të z. B. A. – trupi gjykues çmoi se

⁴ Në datën 16.02.2023, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimin të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit “Parashtrime në lidhje me ankimin e bërë nga subjekti ndaj vendimit nr. 282, datë 06.08.2020, të Komisionit të pavarur të Kualifikimit”.

⁵ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁶ Neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimin [...]”.

dokumentet e sipërcituara nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit, si rrjedhojë, paraqitja e tyre në këtë fazë nuk plotëson kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit provat e reja në ankim mund të paraqiten vetëm në kushtet kur ankuesi provon pamundësinë për t'i paraqitur ato në shqyrtimin në shkallë të parë. Gjithashtu, këto akte nuk përmbajnë informacion të ri, mbi të cilin do të provohej diçka ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, për pasojë trupi gjykues çmoi se është e panevojshme marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

10.3 Lidhur me aktet⁷ e paraqitura me parashtrimet, trupi gjykues vlerëson se nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas të cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe, për këto arsye, përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes.

B. Vlerësimi i shkaqeve të tjera të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

11. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një gjykimi të njëanshëm, subjektiv dhe të pabazuar në prova, pasi sipas parashikimeve kushtetuese e ligjore Komisioni është jo vetëm një organ vlerësues e gjykues, por edhe njëloj "akuzuesi" për shkeljet që ka konstatuar, duke qenë në njëfarë kuptimi edhe palë në këtë proces, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji ka konsoliduar tashmë në praktikën e tij gjyqësore qëndrimin se kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces i nisur kryesisht dhe në përputhje me kompetencën që atij ia njeh Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të tij. Ushtrimi i këtyre kompetencave nga një organ i vetëm është pranuar nga Komisioni i Venecias⁸, më tej është konsideruar në përputhje me parimet kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 dhe së fundmi është konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "GjEDNJ"), në vendimin që i përket çështjes Xhoxhaj kundër Shqipërisë⁹, në të cilin kjo gjykatë është shprehur: "Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkuases, nuk mund të konsiderohet se sjellin në

⁷ Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

- (i) analizë financiare e të ardhurave, nënshkruar nga ekspertja kontabël e miratuar, znj. M. U.;
- (ii) deklaratë, datë 02.02.2023, e z. F. H., me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 10.02.2023;
- (iii) urdhër, datë 21.10.2005, i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për ndarjen e pasurisë arë të z. B. A., nga pasuria me pronar "Shtet";
- (iv) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, për z. G. A., për periudhën qershor 2007 deri më dhjetor 2008, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- (v) një CD, e cila sipas shënimit të subjektit të rivlerësimit në zarf, përmban 2 foto dhe 2 video të objektit informal për vitet 2021-2023.

⁸ Komisioni i Venecias, në Opinionin CDL-AD (2016)036 për ligjin nr. 84/2016, është shprehur: "Duhet të mbahet parasysh edhe fakti se neni 4, paragrafi 4 i Aneksit të Kushtetutës, i jep shprehimisht Komisionit të Pavarur dhe Kolegjit të Apelimit kompetenca të gjera për t'i investiguar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, organet zyrtare duhet të bashkëpunojnë dhe të venë në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelit, duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në databazën e tyre. Po ashtu, neni 45 i Ligjit të Vettingut i lejon anëtarët e Komisionit të Pavarur dhe të Kolegjit të Apelit të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes. Neni 57, pika 4 parashtron parimin se në procesin vendimmarrës të Komisionit të Pavarur, përfundimet nxirren nga trupi gjykues".

⁹<https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%7B%22document%22%7D,%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D>, paragrafët 307 dhe 308.

vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkuases në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme, është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë. [...] Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkuases, dhe detyrës së saj për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkuases. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që Komisioni konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkuases, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e Komisionit”.

Në konkluzion, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk përbën një gjykatë të pavarur e të paanshme, pasi e njëjta trupë gjykuese ka bërë vlerësimin dhe ka ngritur dhe “akuzën”, gjendet i papazuar në ligj.

12. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim, se *seanca dëgjimore dhe shpallja e vendimit kanë ndodhur kur subjekti i rivlerësimit ishte duke kryer lejen e zakonshme vjetore të magjistratit, në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës*, duke argumentuar se:

12.1 *Përcaktimi i bërë në nenin 147 të Kodit të Punës është i zbatueshëm në këtë rast, si gjerësisht në çdo praktikë administrative të sektorit privat e publik.*

12.2 *Përcaktimi i bërë në nenin 46 të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen zbatim, pasi ky nen nuk përlligj në asnjë rrethanë kryerjen e procedurës së rivlerësimit në kohën kur subjekti është duke kryer lejen vjetore. Përkundrazi, ky nen i dedikohet procedurës së njoftimit dhe komunikimit me subjektin e rivlerësimit, por jo zhvillimit të seancës dëgjimore dhe shpalljes së vendimit.*

13. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se në nenin 46 të ligjit nr. 84/2016¹⁰, legjislatori në përdorimin e termit “njoftim”, ka përfshirë të gjitha llojet e njoftimeve dhe komunikimeve që mund t’i adresohen subjektit të rivlerësimit, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit. Në pikën 2 të nenit të sipërcituar, është parashikuar si një mundësi qenia e subjektit të rivlerësimit me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, dhe në këtë rast është parashikuar njoftimi në adresën elektronike private, çka nënkupton se edhe në këto raste procesi i rivlerësimit do të vazhdojë.
14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në rastin konkret duhet të zbatohet neni 147 i Kodit të Punës, i cili zbatohet gjerësisht në çdo praktikë administrative të sektorit privat e publik, trupi gjykues vlerëson se për sa i përket zhvillimit të procesit të rivlerësimit, legjislacioni i zbatueshëm përbëhet nga parashikimet kushtetuese dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016, dhe kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave

¹⁰ Neni 46, i titulluar “Njoftimi”, i ligjit nr. 84/2016, parashikon se:

“1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji.

3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit.

4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.”

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të ligjit të posaçëm, sipas parashikimit të nenit 4, pika 6 e tij.

15. Në këto kushte dhe në mbështetje të faktit se nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision, më datë 03.08.2020, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë njoftuar Komisionin se ka qenë me pushimet vjetore dhe për këtë shkak, të ketë kërkuar shtyrjen e datës së seancës dëgjimore publike, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të sa më sipër, gjenden të pabazuara në fakte e në ligj.

16. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimi i Komisionit ka karakterin e një dënimi penal dhe është me fuqi prapavepruese*, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se:

16.1 GjEDNj-ja ka theksuar se për të vendosur për ekzistencën e një dënimi penal, është e nevojshme të merren në konsideratë tre faktorë, si kualifikimi ligjor i masës në ligjin e brendshëm, thelbi i natyrës së masës së dhënë, si dhe natyra dhe shkalla e ashpërsisë së sanksionit, ndërsa Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 33/2016 ka konkluduar se “ashpërsia e gjobave në rastin konkret është e tillë sa ato në thelb shndërrohen në dënime penale”. Vendimet e GjEDNj-së dhe vendimi i cituar i Gjykatës Kushtetuese përbëjnë bazën më të fortë të klasifikimit të vendimit të Komisionit, për nga ashpërsia e tij, si vendim që në thelb shndërrohet në vendim penal.

16.2 Nga shkalla e ashpërsisë së sanksionit të marrë ndaj subjektit të rivlerësimit, vlerësohet lehtësisht se ai është tejet serioz dhe i rëndë, pasi:

a) Masa e shkarkimit nga detyra është e menjëhershme, ndërsa siç parashtrohet në Kushtetutë, qenia gjyqtar është e përjetshme.

b) Ligji nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”, në nenin 13, pika 1, shkronja “e” ndalon në mënyrë permanente edhe të drejtën e fitimit të titullit të avokatit, prej atij që është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit si pasojë e procesit të rivlerësimit.

c) Deklarata e pasurisë së rivlerësimit që subjektet duhet të deklarojnë para ILDKPKI-së, e shoqëruar kjo me kalimin e barrës së provës përbën një “*selfincrimination*” për gjyqtarin në këtë proces.

16.3 Një masë ndëshkuese e tillë nuk pushon së qeni “ndëshkim” për zbatim të nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se është hartuar me bazë ligjore një ligj të ndryshëm nga Kodi Penal dhe është miratuar nga një organ administrativ.

17. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakun ankimi, trupi gjykues vëren se parimet e përgjithshme të referuara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, si të cenuara gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, i përkasin fushës së të drejtës penale dhe proceseve gjyqësore me karakter penal. Ndërkohë që, referuar dispozitave të Aneksit të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë rregullat dhe parimet e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ky proces ka natyrë administrative dhe jo penale. Për rrjedhojë, vlerësimi i gjetjeve nga hetimi administrativ në kuadër të vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit dhe i tërë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, nuk u nënshtrohet standardeve të drejtësisë penale. Në këtë kontekst, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjenden të pabazuara në ligj.

18. Në vijim të analizës të këtij shkakun ankimi, trupi gjykues vëren se kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit i është nënshtruar vlerësimi të Gjykatës Kushtetuese, e cila, në referim të opinionit të Komisionit të Venecias, ka vlerësuar se: “[...] Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, sistemi i

rivlerësimi ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]”.

Në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra e cila jepet si rezultat i procesit të rivlerësimit të magjistratit, është e parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Në nenin 179/b, pika 7 e Kushtetutës parashikohet se: “Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë”.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit se për shkak të masës disiplinore, ka humbur mundësinë për punësim, pasi sipas parashikimeve të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”, gjyqtarët e shkarkuar nga procesi i rivlerësimit ndalohen në mënyrë permanente të fitojnë titullin e avokatit, trupi gjykues sjell në vëmendje arsyetimin e GjEDNj-së lidhur me të njëjtat pretendime të shtruara përpara kësaj gjykate në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë. GjEDNj-ja ka arsyetuar se: “Gjykata vëren më tej se, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra passjell një ndalim të përjetshëm për t’u rifutur në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë, gjykata përsërit se gjyqtarët, dhe posaçërisht ata që zënë pozicione që sjellin një shkallë të lartë përgjegjësie, siç janë pozicionet në të cilat kërkuesja dëshiron të rifillojë punësimin, kanë një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike, nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë [...]. Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses”.
20. Sa i takon pretendimit se kalimi i barrës së provës subjektit të rivlerësimit përbën një “*selfincrimination*” për gjyqtarin në këtë proces, trupi gjykues çmoi se, referuar parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal, Komisioni, me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ, nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për t’u mbrojtur, por përkundrazi ka zbatuar me përpikëri procedurën e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit kushtetues dhe atij ligjor.
21. Në përfundim të sa më sipër, në referim edhe të jurisprudencës së GjEDNj-së, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në fakte dhe në ligj.
22. Shkakun e ankimit, sipas të cilit: *Komisioni, për raste me problematika të ngjashme me ato të konstatuara për subjektin e rivlerësimit, ka bërë zgjidhje ligjore të ndryshme, duke mbajtur standard të dyfishtë*, subjekti i rivlerësimit e ka argumentuar me citimin e disa vendimeve, në të cilat, sipas tij, qëndrimi i Komisionit ka qenë i ndryshëm nga ai i mbajtur në vlerësimin ndaj tij, megjithëse subjektet e tjera të rivlerësimit kanë qenë në situata faktike të ngjashme me të.

23. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendime të tilla të subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjnë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Ky qëndrim i trupit gjykues mbështet nga jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Kolegjit.
24. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet përpara zbatimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 që legjitimon shkarkimin nga detyra, pasi mungon kushti kumulativ, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit mund të shkarkohet vetëm nëse ka bërë njëkohësisht deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë dhe figurës*, trupi gjykues sjell në vëmendje se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tilla të subjekteve të rivlerësimit si të pabazuara në ligj, për sa kohë konstatimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si situata të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, vlerësimi i të cilave në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i nënshtrohet rast pas rasti parimit të proporcionalitetit.
25. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *masa disiplinore e shkarkimit nga detyra e dhënë nga Komisioni, është një masë ndëshkimore tepër e rëndë, e cila nuk është në proporcion me pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ*, trupi gjykues konstatoi se në çështjen konkrete, Komisioni, në ushtrim të kompetencave të veta për vlerësimin e provave dhe rëndësinë e tyre provuese, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit për kriterin e pasurisë ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm; për kriterin e kontrollit të figurës ka arritur nivel të besueshëm, ndërsa për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale subjekti ka arritur nivelin minimal të kualifikimit. Konkluzionet e Komisionit për pasaktësi dhe pamjaftueshmëri të deklarameve të subjektit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, të parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, janë shkaqe që çojnë në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 3 e këtij ligji. Trupi gjykues do të arsyetojë dhe konkludojë lidhur me këtë shkak ankimi, në vijim, nëse gjen vend aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
26. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *për vlerësimin e aftësive profesionale nga ana e Komisionit, nuk është bërë asnjë analizë dhe nuk është marrë në shqyrtim asnjë provë apo akt tjetër i ndryshëm nga ato që ka marrë dhe ka analizuar KLGj-ja për të dalë në konkluzion të ndryshëm*, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se: *Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues. Në kundërshtimin e këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se është dakord me vlerësimin e bërë nga KLGj-ja, ndërsa Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim akte apo prova të tjera të ndryshme nga ato që ka analizuar KLGj-ja në raportin e vlerësimit profesional për të dalë në konkluzion të ndryshëm.*

27. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në verifikim të vendimit të Komisionit, konstatoi se përpos raportit të KLGj-së, Komisioni ka marrë në shqyrtim edhe denoncimet e publikut, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale. Komisioni ka administruar raportin e analizës së vlerësimit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, të hartuar nga KLGj-ja, në të cilin, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nuk janë dhënë konkluzione dhe, më pas, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi gjetjet e konstatuara në raportin e sipërcituar, si dhe në denoncimet e publikut¹¹.
28. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, pasi Komisioni ka vepruar në përputhje me interpretimin pajtues të ligjit nr. 84/2016, të bërë nga Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2/2017, në të cilin gjykata është shprehur se: *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i këtij rivlerësimi është identifikimi i personave që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit (pika 1). Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi, kurse vlerësimi i aftësisë për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës (pika 2). Sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional brenda 30 ditëve nga data e hyrjes së tij në fuqi dhe e dërgon atë pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale. [...] Kurse neni 43 i ligjit parashikon se procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale rishikon dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi dhe në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, i cili i paraqitet KPK-së. Në përfundim, sipas nenit 44, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë etj., dhe propozon për subjektin e rivlerësimit nëse është “i aftë”, “me mangësi” ose “i papërshtatshëm”. Edhe pse në këtë rast Kushtetuta nuk ka parashikuar specifikisht organin që do të kryejë kontrollin paraprak të deklaratës së dorëzuar nga gjyqtarët dhe prokurorët, me përjashtim të Shkollës së Magjistraturës, e cila është ngarkuar me kryerjen e testimit për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, sipas nenit 10/3 të ligjit organet e vlerësimit të aftësive profesionale janë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që funksionon sipas ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme ose institucionet që bëjnë vlerësimin profesional sipas ligjit. Gjykata vlerëson se këto organe nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore në mënyrë të shkëputur nga veprimtaria e organeve të rivlerësimit, KPK-ja dhe KA-ja, por nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre të fundit. Për shkak të misionit që ato kanë dhe funksionit që kryejnë, qëllimi i përfshirjes së tyre në këtë proces është që të ndihmojnë organet kushtetuese në ushtrimin e kompetencave kushtetuese. Duke bërë një interpretim të tillë të këtyre dispozitave ligjore, konkludohet se edhe në këtë rast ligji nuk e ka zhvendosur kontrollin dhe hetimin tek organet ekzistuese dhe ato nuk kanë marrë dhe as nuk ushtrojnë kompetencat që u njihen organeve të reja kushtetuese.*

¹¹ Në vendim, Komisioni është shprehur se vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, kreu VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku në përfundim ky organ ka lëshuar një raport të hollësishëm.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

29. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi me sipërfaqe 92 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër”, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzionet e Komisionit janë subjektive e të pabazuara, trupi gjykues konstatoi si vijon.
30. Komisioni në vendim, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arsyetuar se:
[...] 27.1 Në lidhje me burimin e krijimit hua, subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet midis deklaramive të kryera ndër vite në lidhje me huadhënësin. 27.1.1 Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë se në deklaratën e vitit 2006 nuk është deklaruar se kjo hua është marrë nga shtetasi S. B., por referohet si huamarrje në persona të afërm dhe familjarë, dhe në deklaramin e vitit 2007 deklarohet shlyerja e huave pa përcaktuar shtetasin S. B.. [...] Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të viteve 2006 - 2007 të subjektit, vlerën e provës në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile. [...] Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaram në deklaratën “vetting”, krahasuar me DPV-të e këtyre viteve në lidhje me huan. Ky ndryshim konsiderohet nga trupi gjykues si përpjekje për të përmbushur detyrimin ligjor të justifikimit të burimit të ligjshëm të huas, shërbyer për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme. 27.7 Nga analiza e rrethanave faktike si më sipër, është e pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklaramet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me huan dhe huadhënësit si burim krijimi i kësaj pasurie.
28. Në lidhje me burimin “overdraft”, në shumën 270.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë [...] 28.3 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga “overdraft-i”, trupi gjykues, bazuar në deklaramin e vetë subjektit në vitin 2006, arrin në përfundimin se ky “overdaft” nuk është përdorur si burim krijimi për këtë pasuri.
28.4 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë kursime, të siguruara nga puna ndër vite [...] 28.4.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 pakësimin e gjendjes “cash” për krijimin e pasurisë apartament, si dhe nuk ka deklaruar të ardhurat si burim krijimi. [...] 28.4.6 Në analizë të DPV-së së vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes “cash” për krijimin e pasurisë apartament, por ka deklaruar se pasuritë e tjera të luajtshme dhe të paluajtshme kanë mbetur si në deklaramin e mëparshëm.
Në përfundim të këtij arsytimi, Komisioni, lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 92 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, ka arritur në konkluzionin se: subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare në krijimin e saj, sipas parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk provohet që kursimet dhe “overdraft-i” janë përdorur për këtë pasuri dhe subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaram në deklaratën e rivlerësimit në lidhje me huan, për të përmbushur detyrimin ligjor të justifikimit të burimit të ligjshëm të saj.
31. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si subjektiv e të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e secilit prej burimeve të deklaruara të kësaj pasurie, në deklaratën e rivlerësimit. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka dhënë shpjegime të hollësishme dhe ka paraqitur prova se, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme, duke argumentuar si vijon.
31.1 Lidhur me huan e marrë nga z. S. B.:
(i) Fakti që nuk ka deklaruar emrin e huadhënësit në deklaratën periodike, nuk e bën inekzistente huan, pasi ajo është deklaruar para inspektorit të ILDKPKI-së në vitin 2015 e në deklaratën e rivlerësimit dhe huaja është pranuar nga vetë huadhënësi me deklaratë noteriale. Mosdeklarami i

huadhënësit nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, ka qenë pa ndonjë qëllim, por për shkak të mungesës së përvojës në plotësimin e deklaratës së pasurisë, pasi kanë qenë vitet e para në plotësimin e saj.

(ii) Pa ndryshuar asnjë rrethanë edhe gjatë seancës dëgjimore, Komisioni ka arritur në dy konkluzione të ndryshme, në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vendim. Duke qenë se ka deklaruar se ka qenë i paqartë në lidhje me huan, Komisioni duhej t'i kërkonte subjektit të rivlerësimit prova të tjera ose të merrte vetë prova, për të qartësuar situatën në lidhje me këtë burim.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin që provon mundësinë financiare të z. S. B. për të dhënë huan në shumën 1.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të hetojë lidhur me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë tregtare të huadhënësit, pasi në bindjen e tij, aktiviteti i ushtruar dhe xhiroja e deklaruar kanë qenë të mjaftueshme për të garantuar se ai ka pasur mundësi të jepte huan me të ardhura të ligjshme.

31.2 Lidhur me *overdraft*-in në shumën 270.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *overdraft*-in në shumën 270.000 lekë e ka marrë dhe e ka përdorur për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 92 m². Subjekti ka argumentuar se në datën 01.08.2006, llogaria bankare rezulton me debi në vlerën 125 lekë, duke u mbajtur komision nga banka, çka do të thotë se nëse më datë 26.07.2006, balanca nuk ka qenë negative, më datë 01.08.2006 rezulton debi në shumën e sipërcituar, pa bërë asnjë transaksion financiar në llogari pas datës 26.07.2006. Kjo mund të ketë ndodhur nga ndonjë pasaktësi e bankës në hedhjen e të dhënave në sistem, lidhur me miratimin e *overdraft*-it.

31.3 Lidhur me kursimet e siguruara nga puna ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankimi se ka çmuar se duke qenë se ka deklaruar blerjen e apartamentit dhe burimet e kësaj blerjeje, nuk e ka vlerësuar se duhet të deklarohet pakësimi i gjendjes *cash*, por këtë pasaktësi nuk e ka përdorur në asnjë nga deklaratat në vijim për të shtuar në mënyrë fiktive të ardhurat apo pasuritë.

32. Në shqyrtimin dhe analizën e këtij shkakut ankimi, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

(i) *Lidhur me huan e marrë nga z. S. B.:*

33. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me nr. {***}, sip. 92 m², blerë në vitin 2006 nga unë dhe bashkëshorti im, me para të kursyera, të marra hua dhe "overdraft" tre paga mujore, shlyerja e së cilës është bërë me kredi. Vlera: 2.000.000 lekë. Pjesa në %: 50%.*

Në të njëjtën deklaratë, bashkëshorti i subjektit, z. G. A., ka deklaruar: *Hua e marrë në "cash" nga shtetasi S. B., në shumën 1.000.000 lekë, në vitin 2006, për blerje shtëpie. Deklarata noteriale nr. {***}, datë 16.03.2015.*

34. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi dy dhoma e një kuzhinë, sip. 92 m², blerë më dt. 09.08.2006, pasuria nr. {***}. Vlera: 2.000.000 lekë.*

Pasuritë e tjera të luajtshme e të paluajtshme kanë mbetur si në deklarinimin e mëparshëm.

Detyrime hua, "cash" në persona privatë, në shumën 1.000.000 lekë. E pashlyer.

"Overdraft" në shumën 270.000 lekë, pjesërisht e shlyer. Marrë më datë 20.08.2006.

Në të njëjtin deklarinim, në rubrikën "Të dhëna konfidenciale", subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Huadhënës janë persona të afërm të familjes dhe nga të njohurit. Huaja në "cash".*

35. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pasuritë e paluajtshme pa ndryshime. Borxhi i deklaruar më parë, shlyer tërësisht. Të tjera pa ndryshime. [...] “Overdraft”, deri më datë 31.12.2007, i shlyer tërësisht. Kredi bankare Raiffeisen Bank ShA, dega Shkodër, kontrata datë 12.12.2007, shuma e kredisë 1.000.000 lekë. Qëllimi: Për shlyerje borxhi dhe rregullim shtëpie. Deri më datë 31.12.2007, pa shlyer asnjë këst.*
36. Bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2015, të z. S. B., i cili ka deklaruar se: *[...] në vitin 2006, i kam dhënë hua shtetasit G. A. [...] shumën prej 1.000.000 lekësh, me qëllim që ky i fundit të blinte një apartament banimi. Në vitin 2007, shtetasi G. A. më ka kthyer shumën në fjalë sipas afatit që kishim vendosur për kthimin e huas në fjalë.*

37. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se:

37.1 Më datë 08.01.2020, Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit kërkesën: *Tregoni lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. S. B. deri në vitin 2006, si dhe mundësitë financiare për dhënien hua të shumës prej 1.000.000 lekësh. Si dhe kur u pagua kjo hua? Cila është marrëdhënia juaj apo e bashkëshortit me z. S. B.?*

Në shpjegimet e dhëna mbi këtë kërkesë të Komisionit, subjekti ka deklaruar: *[...] bashkëshorti im ka lidhje farefisnore me shtetasin S. B. [...]. S. B., sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit, figuron i regjistruar si person fizik më datë 15.10.2002 sipas ekstraktit, por që është fakt i njohur botërisht se ai e ka ushtruar aktivitetin disa vite para kësaj date, pasi bar-restorant “{***}” është një nga lokalet më të njohura të qendrës së qytetit Shkodër. Sipas vërtetimit të lëshuar nga DRT Shkodër, më datë 23.01.2020, ky subjekt ka deklaruar xhiro përkatësisht: për vitin 2005: 6.400.000 lekë; për vitin 2006: 7.700.000 lekë.*

Bashkëlidhur përgjigjes si cituar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur:

37.1.1 Vendimin nr. {***}, datë 06.03.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për regjistrimin e aktivitetit privat të kërkuarit S. B. si person fizik për bar-bufe “{***}”, me qendër në lagjen “{***}”, Shkodër.

37.1.2 Ekstraktin historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit Person Fizik, me NUIS {***}, S. B., me datë regjistrimi 15.10.2003, fusha e veprimtarisë: “bar, kafe, rostiçeri”.

37.1.3 Shkresën nr. {***} prot., datë 23.01.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër (në vijim “DRT”), drejtuar z. S. B., në të cilën ky institucion vërteton se *subjekti S. B., me NUIS {***}, i përfaqësuar nga administratori, z. S. B., ka raportuar sipas deklaratave të tatimit të thjeshtuar të fitimit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, xhiro si më poshtë vijon: viti 2005 - totali i shitjeve 6.400.000 lekë; viti 2006 - totali i shitjeve 7.700.000 lekë.*

37.2 Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për vërtetimin e lëshuar nga DRT Shkodër, mbi xhiron e deklaruar nga subjekti S. B., nuk përputhet me legjislacionin në fuqi në kohën e këtij veprimi, sipas të cilit personi fizik kishte mundësi të krijonte të ardhura deri në 2.000.000 lekë dhe mbi këtë tavan të të ardhurave të mundshme, nga subjekti mund të realizoheshin të ardhura vetëm në kohën kur u regjistrua shoqëria “{***}” ShPK, me aksioner S. B., më datë 24.11.2005. Në përmbledhje të sa më sipër, duket se: *ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me huadhënien e kësaj shume, pasi në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti deklaroi se e ka marrë këtë hua nga persona privatë, ndërkohë që në procesverbalin e vitit 2015 pranë ILDKPKI-së dhe në atë vetting deklaroi se e ka marrë këtë*

hua nga personi tjetër i lidhur z. S. B.. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion provues marrjen e kësaj huaje në korrik të vitit 2006, por vetëm në vitin 2015 kur është pyetur nga ILDKPKI. Personi tjetër i lidhur z. S. B. nuk provon me dokumentacion ligjor provues, mundësinë financiare të dhënies hua në vitin 2006 të vlerës 1.000.000 lekë.

*Në shpjegimet mbi konstatimin e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Nga ana ime është deklaruar si borxh i marrë në “cash” nga persona të afërm të familjes dhe të njohur, por nuk është evidentuar emri i huadhënësit, pa ndonjë qëllim, kjo mbase edhe për shkak të mungesës së përvojës në plotësimin e deklaratës së pasurisë, pasi kanë qenë vitet e para që ne plotësonim deklaratat vjetore të pasurisë.[...] Mungesa e identifikimit të personit që unë kam marrë hua në vitin 2006, nuk e bën borxhin inekzistent, për sa kohë unë kam marrë kredi në vitin 2007 për ta shlyer atë dhe kjo huadhënie pranohet edhe nga vetë huadhënësi. [...] vlerësoj se vërtetimi i lëshuar nga DRT Shkodër për këtë subjekt, është i mjaftueshëm për të provuar mundësinë financiare, për sa kohë ai është një dokument zyrtar. Këtu shtoj faktin se sipas relacionit tuaj, ai ka themeluar shoqërinë “{***}” ShPK në datë 24.11.2005, pra 8 muaj para se unë të marr hua nga ky shtetas. Pra, duke marrë në konsideratë faktin se ai ka ushtruar aktivitet biznesi në bar restorant “{***}” edhe para vitit 2005, ai i ka pasur të gjitha mundësitë financiare për të dhënë hua shumë prej 1.000.000 lekësh në muajin korrik 2006.*

38. Në analizë të rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2006 nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 92 m² në Shkodër. Në të njëjtën deklaratë, megjithëse ka deklaruar marrjen e një huaje, subjekti nuk ka deklaruar arsyet e marrjes dhe destinacionin e përdorimit të shumës së marrë hua në vlerën 1.000.000 lekë dhe gjithashtu, nuk ka deklaruar as identitetin e huadhënësve, por është mjaftuar vetëm me një deklaram të përgjithshëm se huaja është marrë nga *persona të afërm të familjes dhe nga të njohurit*. Faktin e marrjes së huas nga disa persona, subjekti e ka theksuar në këtë deklaratë periodike, duke e deklaruar në dy rubrika të ndryshme të formularit të deklaramit. Edhe në deklaratën periodike të vitit 2007, edhe pse ka deklaruar shlyerjen tërësisht të huas, subjekti i rivlerësimit përsëri nuk ka deklaruar se kujt ia ka shlyer këtë detyrim. Identiteti i personit huadhënës shfaqet për herë të parë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në të cilën qartësohen elementet e tjera të marrëdhënies së huas: arsyet e marrjes së saj – me qëllim blerjen e apartamentit me sipërfaqe 92 m², si dhe identiteti i huadhënësit, z. S. B.. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokumentacion justifikues deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2015, të z. S. B., në të cilën ky i fundit pranon dhënien e huas, në shumën 1.000.000 lekë ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit¹², e njëjta deklaratë noteriale e paraqitur edhe më parë në ILDKPKI, në vitin 2015, për të vërtetuar dhënien e huas nga z. B., në vitin 2006.
39. Lidhur me sa më sipër, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mosdeklarimi i huadhënësit në deklaratat periodike ka qenë pa ndonjë qëllim, por për shkak të mungesës së përvojës në plotësimin e deklaratës së pasurisë, pasi kanë qenë vitet e para në plotësimin e saj, trupi gjykues nuk e vlerësoi bindës, pasi formulari i deklaramit të interesave privatë dhe pasurisë së vitit 2006, në faqen nr. 5, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ndër të tjera shpjegonte: “Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të plotësohen në fletën nr. 6, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre”. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e zyrtarit deklarues, ka plotësuar këtë fletë të formularit duke deklaruar vetëm detyrimin në shumën 1.000.000 lekë dhe jo të dhënat e personave ndaj të cilëve e kishte këtë detyrim. Në faqen nr. 6, në rubrikën “Të dhëna

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2020, ILDKPKI-ja ka përcjellë në Komision dokumentacionin që dispononte për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha. Nga aktet e përcjella nga ILDKPKI-ja në Komision, nuk evidentohet se në cilat rrethana subjekti ka dorëzuar në këtë institucion, në vitin 2015, deklaratën noteriale të sipërcituar, për një hua të marrë dhe të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006.

konfidenciale”, formulari kërkonte qartësisht nga zyrtari deklarues, të plotësonte të dhënat konfidenciale lidhur me identitetin e personit juridik ose fizik, huadhënës a huamarrës. Subjekti nuk e ka përmbushur këtë detyrim, duke mos deklaruar identitetin e personave huadhënës, por ka deklaruar vetëm faktin se huadhënësit janë persona të afërm të familjes dhe të njohurit. Nga sa më sipër, rezulton se edhe në eventualitetin e moskuptimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), formulari i deklarimit ishte i qartë në kërkesat e tij, duke i dhënë mundësinë subjektit ta plotësonte saktësisht atë. Në ndryshim nga sa ka deklaruar në këtë formular, se huaja është marrë nga disa individë, të afërm dhe të njohur, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se kjo hua është marrë nga një individ i vetëm, nga z. S. B., i cili rezulton me një lidhje farefisnore të largët me të¹³. Në këto kushte, në ballafaqim të deklarimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe deklarimeve në deklaratat periodike të interesave të vitit 2006 e vitit 2007, trupi gjykues vlerësoi se është i drejtë konkluzioni i arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarim në deklaratën e rivlerësimit, krahasuar me deklaratat periodike në lidhje me huan, por çmon të theksojë se ky ndryshim evidentohet vetëm me deklarimin e të dhënave të sakta dhe të plota lidhur me huadhënësin. Në vijim të sa më sipër, si dhe të rrethanave faktike mbi deklarimet e subjektit në deklaratat periodike e në atë të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit. Këtë cilësim ua njeh vetë ligji i posaçëm nr. 84/2016 në nenin 32, pika 5 e tij, për të provuar nëpërmjet tyre, deklarimet e bëra në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasuritë e deklaruara¹⁴. Në këtë kuptim, e gjithë situata e mosdeklarimit të të dhënave të sakta dhe të plota të huadhënësit në deklaratat periodike të interesave, jo vetëm nuk e ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin e rivlerësimit në drejtim të vendosjes së masës disiplinore në ngarkim të tij, por as nuk mund të afektojë procesin e kontrollit të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit objekt kontrolli, në kushtet kur në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, konkretisht parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, objekt i kontrollit janë pasuritë për të cilat subjekti mbarte detyrimin për t’i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe që janë relevante në këtë proces dhe kontrolli fillon nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në të, një qëndrim tashmë i konsoliduar ky në jurisprudencën e Kolegjit¹⁵. Në këtë kuptim, e në kushtet kur: a) në deklaratat periodike të interesave gjenden të deklaruara elementet e tjera të marrëdhënies së huas, të cilat përputhen me ato të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit; b) huadhënësi S. B., nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2015, ka konfirmuar marrëdhënien e huas dhe cilësinë e tij si huadhënës; si dhe c) Komisioni nuk ka konkluduar se subjekti ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, çka do të përbënte rrethanë që duhej vlerësuar e analizuar në mënyrë të posaçme; trupi gjykues vlerësoi se Komisioni nuk gjendej në kushtet e pamundësisë për të arritur në një konkluzion mbi situatën e vërtetë faktike lidhur me huan dhe huadhënësin, por burimi i krijimit objekt kontrolli, duhej të verifikohet nga Komisioni sipas deklarimit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

¹³ Ashtu siç ka shpjeguar subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar nga Komisioni më datë 08.01.2020.

¹⁴ Në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit në vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 7/2018 (JR), nr. 8/2018 (JR), nr. 9/2018 (JR), nr. 10/2018 (JR), nr. 12/2018 (JR), nr. 9/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR).

¹⁵ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021; vendimi nr. 2/2022, datë 15.02.2022 etj.

40. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka paraqitur dokumentacionin që provon mundësinë financiare të z. S. B. për të dhënë huan në shumën 1.000.000 lekë, me burime të ligjshme financiare.
41. Në verifikim të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, rezultojnë se të dhënat lidhur me mundësinë financiare të z. S. B. për të dhënë huan, kufizohen vetëm në të dhënat e shkresës nr. {***} prot., datë 23.01.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, sipas së cilës z. B. ka ushtruar aktivitet tregtar, i regjistruar si person fizik, dhe në bazë të deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, ka realizuar xhiro vjetore në vitet 2005 dhe 2006, përkatësisht në vlerat 6.400.000 lekë dhe 7.700.000 lekë. Edhe pse nga Komisioni i ishte ngarkuar barra e provës për të provuar mundësinë e z. B. për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 1.000.000 lekësh, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion tjetër justifikues për këtë qëllim, por është mjaftuar vetëm me shkresën e DRT Shkodër, të paraqitur në përgjigje të pyetësorëve drejtuar nga Komisioni. Bazuar vetëm në këto të dhëna, trupi gjykues nuk mundi të arrijë në përfundime lidhur me mundësinë financiare të z. B., deri në korrik të vitit 2006, për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua, pasi nga të dhënat e përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, nuk mund të evidentohet sa ka qenë fitimi i realizuar prej tij si person fizik, në këto vite të ushtrimit të aktivitetit tregtar. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se z. S. B. kishte të ardhura të ligjshme, rezultojnë i paprovuar. Në rrethanat faktike, subjekti i rivlerësimit nuk provon burimin e ligjshëm të huas sipas detyrimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹⁶. Ndërkohë, pretendimi i subjektit se Komisioni “duhet t’i kishte kërkuar prova të tjera ose të merrte vetë prova”, për të qartësuar situatën në lidhje me burimin e të ardhurave të z. S. B., bie ndesh me konceptin e barrës së provës në procesin e rivlerësimit, pasi për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, në zbatim të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, barra e provës i përket subjektit të rivlerësimit. Komisioni, në rezultatet e hetimit, i ka qartësuar subjektit elementet për të cilat ka kërkuar shpjegime dhe prova lidhur me huan, duke përmbushur detyrimin sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.
42. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se pa ndryshuar asnjë rrethanë edhe gjatë seancës dëgjimore, Komisioni ka arritur në dy konkluzione të ndryshme nga rezultatet e hetimit administrativ në vendim. Trupi gjykues vëren se ky pretendim është i lidhur me konstatimin e subjektit të rivlerësimit se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Duke marrë në vlerësim kursimet e deklaruara në fund të vitit 2005 dhe duke konsideruar edhe kursimet për periudhën janar-korrik 2006, duket se subjekti ka pasur mundësi për të kursyer vlerën e deklaruar në momentin e blerjes së pasurisë. Mbështetur edhe në hetimin administrativ të shkresave të përcjella dhe deklaratimet e subjektit, Njësia Ligjore hartoi analizën financiare për vitet 2005-2006, periudhë në të cilën është blerë pasuria dhe shlyer huaja e marrë “cash”. Në bazë të rezultatit të saj pozitiv, duket se subjekti ka pasur mundësi të krijojë pasurinë dhe shlyejë detyrimet me burime të ligjshme të ardhurash. Ndërsa në vendim, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në një konkluzion të ndryshëm, pasi e ka pasur të pamundur të arrijë në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklaratimet që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me huan dhe huadhënësit si burim krijimi i kësaj pasurie. Në verifikim të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se citimi nga rezultatet e hetimit prej subjektit të rivlerësimit, nuk i përket gjetjes së Komisionit lidhur me huan, por u përket konstatimeve lidhur*

¹⁶ Neni 32, pika 4 parashikon: “[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

me burimin tjetër të krijimit të pasurisë objekt kontrolli – kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Në lidhje me huan, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me: [...] *Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion provues marrjen e kësaj huaje në korrik të vitit 2006, por vetëm në vitin 2015 kur është pyetur nga ILDKPKI-ja. Personi tjetër i lidhur, z. S. B., nuk provon me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të dhënies hua në vitin 2006, të vlerës 1.000.000 lekë.* Dhe konkluzioni i arritur nga Komisioni në vendim, lidhur me huan, ka ardhur si rrjedhojë e arsytimit mbi deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Në këto kushte, nuk rezulton se Komisioni ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme apo kontradiktore, lidhur me huan.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për financimin e pasurisë, pasi nuk provon burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 1.000.000 lekësh, të dhënë hua nga z. S. B., në vitin 2006.

(ii) Lidhur me “*overdraft-in*” në shumën 270.000 lekë:

43. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni¹⁷, lidhur me shumën prej 270.000 lekësh *overdraft*, i deklaruar si burim financiar për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 92 m², subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se në pasqyrën e llogarisë së vitit 2006, më datë 18.07.2006, rezulton kreditim në shumën 180.334 lekë, më pas ka kryer tërheqje në datat 18.07.2006, 20.07.2006 dhe 26.07.2006. Në datën 01.08.2006, rezulton me debi 125 lekë, pasi është mbajtur komision nga banka, çka do të thotë se nëse më datë 26.07.2006 balanca nuk ka qenë negative, në datën 01.08.2006 ka pasur debi në shumën e sipërcituar, pa bërë asnjë transaksion financiar në llogari pas datës 26.07.2006. Kjo mund të ketë ndodhur nga ndonjë pasaktësi e bankës në hedhjen e të dhënave në sistem, lidhur me miratimin e *overdraft*-it. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka shprehur edhe në ankim.
44. Trupi gjykues vëren se sipas parashikimeve të nenit 4 të kontratës së shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe 92 m² nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2006, çmimi i shitjes prej 2.000.000 lekësh është likuiduar totalisht nga blerësi brenda zyrës noteriale, pra pagesa për blerjen e pasurisë është kryer nga subjekti i rivlerësimit e bashkëshorti i saj, më datë 31.07.2006. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave të vitit 2006 ka deklaruar se ka detyrim ndaj Bankës Raiffeisen, “*Overdraft* në shumën 270.000 lekë, pjesërisht e shlyer. Marrë më datë 20.08.2006”. Bazuar vetëm në këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike rezulton se *overdraft* është marrë më pas në kohë nga data e kryerjes së pagesës për blerjen e apartamentit, duke e përjashtuar logjikisht atë nga burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli.
45. Pavarësisht kësaj, në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi lëvizjet në llogarinë bankare, nga verifikimi i të dhënave në dokumentacionin bankar të përcjellë në Komision nga Banka Raiffeisen¹⁸, rezultoi se nga data 18.07.2006, datë në të cilën llogaria është kredituar me vlerën 180.334 lekë, deri në datën 31.07.2006, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr vlerën 180.000 lekë dhe pas çdo tërheqjeje, llogaria rezulton të ketë balancë pozitive¹⁹. Ky fakt dëshmon se gjatë

¹⁷ Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për: “*Duket se deklarimi i subjektit të rivlerësimit për përdorimin e overdraft-it si burim për pasurinë, nuk përputhet me shkresat e përcjella dhe informacionin e mbledhur gjatë hetimit administrativ*”.

¹⁸ *Informacion i përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.07.2019.*

¹⁹ *Në datën 18.07.2006, është kredituar llogaria e pagës me nr. {***}, në vlerën 180.334 lekë, në masën e dy pagave. Në datën 18.07.2006, është debituar apo tërhequr vlera 30.000 lekë. Në datën 20.07.2006, është debituar llogaria në vlerën 30.000 lekë. Në datën 26.07.2006, është debituar llogaria në vlerën 100.000 lekë. Në datën 31.07.2006, është debituar llogaria në vlerën 20.000 lekë. Në datën 01.08.2006, është debituar llogaria në vlerën 125 lekë komision fiks.*

kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit ka përdorur likuiditetet bankar nga të ardhurat e pagës pa prekur *overdraft*-in. Në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit se në datën 01.08.2006 ka pasur si debi vlerën prej 125 lekësh, rezulton se kjo vlerë është debituar si komision bankar për mbajtjen e llogarisë, komision i mbajtur në mënyrë të vazhdueshme në fund të çdo muaji. Kjo vlerë nuk është as interes i lidhur me *overdraft*-in dhe as balancë negative e likuiditetit bankar gjendje në datën 01.08.2006. Për rrjedhojë, *overdraft*-i nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, pasi tërheqjet e tij²⁰ kanë ndodhur pas datës së blerjes së saj.

(iii) *Lidhur me kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit:*

46. Në lidhje me burimin e krijimit të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit – para të kursyera, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash*, për herë të parë në deklaratën periodike të interesave të vitit 2004, në të cilën ka deklaruar: *Të holla në lekë, (kursime) “cash”. Vlera 500.000 lekë. Nga qershori 2003 e në vazhdim.*

Në deklaratën periodike të vitit 2005, ka deklaruar: *Është shtuar vetëm vlera e të hollave (kursimeve) në lekë “cash”. Vlera: 700.000 lekë. Pasuritë e tjera të paluajtshme dhe të luajtshme kanë mbetur të pandryshuara.*

Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash*, por ka deklaruar: *Pasuritë e tjera të paluajtshme dhe të luajtshme kanë mbetur si në deklarin e mëparshëm.*

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar: *Në lidhje me konkluzionin se nuk është deklaruar pakësimi i gjendjes “cash” në vitin e blerjes së kësaj pasurie, sqaroj se duke qenë se kam deklaruar blerjen e apartamentit dhe burimet e kësaj blerjeje, nuk e kam vlerësuar (mbase pakujdesi) se duhej të deklarohet pakësimi i gjendjes “cash”. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe në ankim.*

Në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se duke qenë se ka deklaruar burimet e blerjes së apartamentit, nuk ka menduar se duhej të deklaronte edhe pakësimin e kursimeve në *cash*, nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e deklaratës periodike të vitit 2006, në të cilën ajo ka deklaruar vetëm faktin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 92 m², por nuk ka deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 4, paragrafi i parë i ligjit nr. 9049/2003. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjen mbështetje as nga deklarimi i bërë në të njëjtën deklaratë se: *Pasuritë e tjera të paluajtshme dhe të luajtshme kanë mbetur si në deklarin e mëparshëm.* Në vlerësim të përmbushjes së detyrimit për deklarim në mbështetje të kuadrit ligjor, konkretisht nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte pranë organit kompetent, ndër të tjera, vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj, trupi gjykues vëren se subjekti ka deklaruar që kursimet në *cash* nuk kanë pësuar ndryshime, as shtesa dhe as pakësime, në raport me vitin e mëparshëm. Ligji nr. 9049/2003, ashtu edhe formularët e deklarimit, kanë pasur të përcaktuar qartë që në pasurinë likuiditetet përfshihen si likuiditetet në *cash*, ashtu dhe ato në llogarinë bankare. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit edhe në vitet e mëparshme, duket se ajo ka qenë e qartë për

²⁰ Sipas të dhënave bankare, në datën 17.09.2006 është tërhequr vlera 20.000 lekë dhe balanca në këtë ditë rezulton -11.438.5 lekë dhe në datën 21.09.2006 është tërhequr vlera 10.000 lekë dhe balanca rezulton në vlerën -21.438.5 lekë. Ky fakt dëshmon për përdorimin e “*overdraft-it*”. Pas këtyre datave, rezulton që përdorimi i tij të ketë filluar sërish nga data 15.12.2006 deri në datën 30.12.2006. Gjatë kësaj periudhe është tërhequr vlera 205.000 lekë. Shtuar kësaj edhe vlerën 30.000 lekë, të tërhequr në datat 17 dhe 21 shtator 2006, vlera totale e tërhequr nga përdorimi i “*overdraft-it*” rezulton të jetë 235.000 lekë dhe jo 270.000 lekë, sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit.

mënyrën e deklarimit dhe se çfarë përfshihet në konceptin e likuiditetit për efekt të deklarimit. Në kushtet kur sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratat e dorëzuara më parë në ILDKPKI kanë vlerën e provës, trupi gjykues arriti në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se kursimet në *cash* nuk janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 92 m² në Shkodër.

47. Duke përdorur arsyetimin e bërë më sipër, në lidhje me burimet e deklaruara për blerjen e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 92 m², më datë 31.07.2006, në vlerën e 1.539.526 lekëve, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të nenit 32, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
48. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit është i pavërtetë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi deklararon se zotëron pjesë takuese në pasurinë tokë arë me sipërfaqe 19.500 m², por nuk ka deklaruar pjesën takuese që ka mbi ndërtesën e ndërtuar në të, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka arritur në konkluzione lidhur me pasurinë objekt ankimi, gjatë kontrollit e verifikimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 54 m² në Shkodër, në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se është blerë në vitin 2001, me kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2001, në vlerën 500.000 lekë, me kursimet e bashkëshortit, të siguruar nga puna, ndër vite, para vitit 2001. Për këtë pasuri, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2001. Në shpjegimet e dhëna lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] bashkëshorti im ka jetuar derisa ne jemi martuar, në shtëpinë e prindërve të tij dhe në kohën e blerjes së këtij apartamenti, ata kanë pasur të krijuar pasurinë nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, ZK {***}, fshati {***}, lloji pasurisë arë + truall, nga të cilat 202 m² truall dhe 120 m² ndërtesë, regjistruar më datë 10.02.2000, fakt ky që tregon se familja e bashkëshortit ka pasur mundësi financiare për të krijuar këto pasuri. Gjithashtu, familja e bashkëshortit ka edhe tokë tjetër në pronësi, të fituar në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, (ullishte), me sipërfaqe 19.500 m², me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, z. k. {***}, fshati {***}, vërtetuar kjo me AMTP-në nr. {***}, regjistruar në ish-ZVRPP (ASHK) në datën 22.09.1997, nga e cila ata kanë realizuar në kohë të ardhura, duke qenë se është e mbjellë me ullinj. Bashkëlidhur foto të vërtetimit të pronësisë dhe shtëpisë në pronësi të Xh. J..
49. Mbi këtë shpjegim të subjektit të rivlerësimit, në vendim, Komisioni ka arsyetuar se: Komisioni, duke pasur parasysh shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se: Pasuria ndërtesë me sip. 120 m², ndodhur në fshatin {***}, bërë me dije nga foto e dërguar nga subjekti, rezulton të jetë një pronë e familjes bujqësore, mbi pasurinë me sip. 19.500 m², me nr. pasurie {***}, fshati {***}, Shkodër. Mbështetur në situatën faktike më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, pasi nga të dhënat e pasqyruara në këtë deklaratë, ai deklaroi se zotëron pjesë takuese në pasurinë tokë arë, me sip. 19.500 m², me nr. pasurie {***}, fshati {***}, Shkodër, por nuk përfshin pjesën takuese që ka mbi ndërtesën e ndërtuar mbi të. [...] Në këtë kuptim, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit, me pjesë takuese ideale të kësaj pasurie, nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” të drejtat/pjesën takuese mbi pasurinë ndërtesë me sip. 120 m², ndodhur në fshatin {***}.

50. Në pretendimin e tij në ankim, se konkluzioni i mësipërm i Komisionit është i pavërtetë, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se pasuria ullishte me sipërfaqe 19.500 m², me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, fshati {***}, vërtetuar kjo me AMTP, është regjistruar në ASHK më datë 22.09.1997. Kjo pasuri është e mbjellë me ullinj dhe mbi të nuk ka asnjë ndërtesë. Sa i përket shtëpisë me sipërfaqe 120 m², ajo ndodhet në të njëjtin fshat, por në një vend tjetër, afër rrugës kryesore dhe është regjistruar më datë 16.02.2000, në emër të gjyshit të bashkëshortit, duke kaluar më pas me trashëgimi të vjehrrit i subjektit të rivlerësimit. Në kushtet kur bashkëshorti nuk figuron si pronar i kësaj pasurie, subjekti ka argumentuar se nuk ka pasur detyrim për ta deklaruar atë.
51. Në analizë të konkluzionit të Komisionit dhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi këtë konkluzion, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon.
- 51.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Tokë e fituar me ligjin 7501 si familje bujqësore, në emër të kryefamiljarit Xh. J. (A.), nr. {***}, fshati {***}. Sipërfaqe 19.500 m². Bashkëpronësi me familjen e origjinës.*
- Bashkëlidhur deklaratës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “Certifikatë për vërtetim pronësie”, me datë lëshimi 14.11.2007, sipas së cilës z. Xh. J. ka në pronësi pasurinë arë, me nr. pasurie {***}, volumni {***}, ZK {***}, Shkodër, me sipërfaqe 19.500 m².
- 51.2 Nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga ASHK Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.07.2019, rezultoi se:
- i) me AMTP-në nr. {***}, familjes së z. R. J. i janë dhënë në pronësi 14.430 m² tokë, nga e cila 600 m² vreshtë, 430 m² truall, 13.400 m² arë.
- ii) Pasuria me sipërfaqe 19.500 m² është regjistruar në ZK {***}, me nr. pasurie {***}, volumni {***}, faqe {***}, sipas AMTP nr. {***}, në emër të z. R. J., më datë 22.09.1997 e më pas ka kaluar pronësia në emër të z. Xh. J., më datë 14.11.2007.
- iii) Z. R. J. ka pasur në pronësi pasurinë arë + truall, me sipërfaqe totale 3.102 m², nga e cila 202 m² truall, nga i cili 120 m² ndërtesë, në ZK nr. {***}, nr. pasurie {***}, volumni {***}, faqe {***}, në fshatin {***}, sipas AMTP-së nr. {***}. Më pas pronësia mbi këtë pasuri ka kaluar në emër të z. Xh. J., me datë regjistrimi 14.11.2007.
- Pronësinë mbi pasuritë e sipërcituara, z. Xh. J. e ka fituar me anë të vendimit nr. {***}, datë 16.05.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerëve R. e Q. J., duke përcaktuar si trashëgimtar ligjor djalin e tyre, z. Xh. J., vjehrrin e subjektit të rivlerësimit.
52. Nga situata faktike që rezulton nga dokumentacioni i sipërcituar, trupi gjykues vëren se pavarësisht se rrjedhin nga e njëjta AMTP, pasuritë arë me sipërfaqe 19,500 m² me nr. pasurie {***} dhe arë+truall+ndërtesë me nr. pasurie {***}, janë të regjistruara më vete dhe nga të dhënat e certifikatave të pronësisë janë të kufizuara me pasuri të ndryshme. Të dyja këto pasuri, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk i ka përfituar si familje bujqësore nëpërmjet një akti të marrjes së tokës në pronësi, por nëpërmjet trashëgimisë ligjore. Për rrjedhojë, në ndryshim nga sa konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin të deklaronte asnjë nga këto pasuri, pasi nuk ka pjesë takuese në asnjërën prej tyre. Në vlerësim të trupit gjykues, fakti i deklarimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit se ka në bashkëpronësi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 19,500 m², megjithëse përbën një pasaktësi në deklaram, duket më shumë si një perceptim i gabuar i pronësisë mbi tokën bujqësore, për rrjedhojë nuk mund të përbëjë shkak të veçuar për dhënien e masës disiplinore të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

53. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit për sa i përket ndërtimit informal në fshatin {***}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë atë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe ka pasur burime të mjaftueshme për të ndërtuar këtë objekt, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, për pasurinë objekt kontrolli, ka arritur në konkluzionet:
- i. subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
 - ii. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investimet e kryera ndër vite dhe nuk ka deklaruar destinacionin e këtij objekti si bar-restorant, sipas parashikimeve të shkronjës “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
 - iii. subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me truallin e saj, pasi nuk ka deklaruar dhe nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues pronësinë e truallit, mbi të cilin ishte ndërtuar ky ndërtim informal në kundërshtim me parashikimin e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
 - iv. subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë ndërtim informal në fshatin {***}, komuna {***}, Shkodër, në pronësi, në kuptim të pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në kundërshtim me parashikimin e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
54. Në kundërshtim të konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar si vijon.

Sa i përket vlerës së ndërtimit dhe vlerës së arredimit të ndërtimit informal në fshatin {***}, subjekti i rivlerësimit i qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, në të cilat ka sqaruar se investimi ka përfunduar në korrik të vitit 2013 dhe punimet janë kryer me punëtorë privatë të palicencuar, të cilët kanë qenë daja, bashkëshorti dhe një shok i tij. Në mungesë të dokumentacionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktin e vlerësimit të bërë nga eksperti i licencuar, i cili ka konfirmuar se vlera e ndërtimit është sa ka deklaruar subjekti, në shumën 1.400.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të gjitha burimet financiare të përdorura nga bashkëshorti i saj për ndërtimin e objektit informal dhe, gjithashtu, ka provuar para Komisionit se z. B. H. ka pasur mundësi që t'i jepte hua shumën prej 600.000 lekësh, në vitin 2013, shumë e përdorur për ndërtimin e objektit në fjalë. Komisioni nuk ka arsyetuar se përse detyrimi i subjektit ka qenë të provonte bindshëm dhe jo mjaftueshëm vlerën e investimit, duke pasur parasysh se i janë kërkuar prova që i përkasin një periudhe kohore mbi 7 vjet përpara. Komisioni ka përcaktuar vlerën absurde prej 6.638.720 lekësh si vlerë investimi, sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), pa arsyetuar dhe analizuar sesi ka dalë kjo vlerë, pa dhënë referencë konkrete se cilit vit të çmimeve të EKB-së i është referuar, si dhe ka llogaritur objektin dykatësh, ndërkohë që ai është njëkatësh dhe i ngritur nga toka me bazament me blloqe betoni. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka të qartë se çfarë ka pasur parasysh Komisioni, duke u shprehur për vlerën e investimit që i ka rritur vlerën objektit, pasi objekti ka qenë në të njëjtën gjendje ndërtimore që në momentin që është deklaruar për legalizim dhe kjo vërtetohet nga fotot e dosjes së legalizimit. Investimi i mëvonshëm konsiston në blerjen e karrigeve dhe tavolinave të përdorura dhe në blerjen e pajisjeve modeste të kuzhinës, pasi konceptimi si objekt social-ekonomik ka ndodhur në vitin 2015, kur është krijuar prej bashkëshortit të saj shoqëria “{***}” ShPK. Nga aktiviteti si lokal shërbimi nuk është siguruar asnjë vlerë fitimi, pasi ka funksionuar për një kohë të shkurtër dhe vijon të jetë i mbyllur, për shkak të mungesës së personelit dhe xhiros ditore. As vetë Komisioni nuk ka përcaktuar qartë se çfarë është ky investim dhe sa është vlera, e cila duhet të deklarohej në vite nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se

nuk ka deklaruar pronësinë mbi truallin, pasi nuk e ka pasur në pronësi atë dhe as ajo e as bashkëshorti i saj nuk janë thirrur nga ILDKPKI-ja për të plotësuar këtë pasaktësi dhe as është pyetur ndonjëherë nga Komisioni gjatë hetimit, por vetëm në raportin përfundimtar, e pasi ajo deklaroi pronësinë mbi truallin nga ana e Komisionit nuk iu kërkuan të dhëna të tjera.

55. Në këndvështrim të rrethanave të faktit, në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi se ato paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

55.1 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, në lidhje me këtë pasuri, kanë bërë deklarament vijuese.

Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit: *Ndërtim informal në vlerën 1.400.000 lekë për rritjen e shpendëve, dërguar për legalizim në datën 19.07.2013, krijuar me kursime nga të ardhurat dhe hua shtetasit B. H. në shumën 600.000 lekë. Vlera 1.400.000 lekë.*

Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2013: *Ndërtim informal jobanesë, në fshatin {***}, Shkodër. Vlera 1.400.000 lekë. Për legalizim nr. {***} prot., datë 19.07.2013. Ky ndërtim është krijuar me të ardhura financiare nga kursime në vlerën 580.000 lekë, përdorim të llogarisë overdraft, të ardhura nga puna e bashkëshortit si asistent avokat, hua në cash marrë dajës së bashkëshortit shtetasit B. H., nga fshati {***}, në vlerën 600.000 lekë.*

55.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, rezultoi se me shkresë nr. {***} prot., datë 29.01.2020, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Shkodër ka përcjellë informacionin se *subjekti G. Xh. A. rezulton aplikues me kërkesën nr. {***} prot., datë 19.01.2013, deklaruar në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Shkodër. Për ndërtimin informal janë kryer vetëm verifikimet në terren dhe nuk i është nënshtruar procedurave të mëtejshme. Procesi i legalizimit nuk është përmblyllur akoma. Sipas praktikës që gjendet bashkëlidhur informacionit të sipërcituar, z. G. A. ka paraqitur “Kërkesën për legalizimin e ndërtimit pa leje”, me nr. {***} prot., datë 19.07.2013, në të cilën ka vetëdeklaruar të dhënat vijuese: Ndërtim pa leje “Jobanesë”, në adresën Fshati {***}, Komuna {***}, sipërfaqe e bazës së ndërtimit pa leje 100 m², sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit pa leje 220 m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë s’ka, funksioni i ndërtimit “Për rritje shpendësh”, sipërfaqja e truallit të ndërtimit pa leje 1,000 m². Sipas planit të rilevimit, datë 29.08.2016, që shoqëron “Procesverbalin e verifikimit në terren”, kryer nga ALUIZNI Shkodër në datën 29.08.2016, objekti informal socio-ekonomik përbëhet nga kati përdhe i objektit informal, i cili ka plinte e kolona për të mbajtur katin e parë, ndërsa kati i dytë përbëhet nga mure me blloqe betoni, dysheme betoni, soletë dhe mbulesë llamarine. Objekti ka edhe një pistë me konstruksion metalik e dysheme druri.*

I njëjti dokumentacion është përcjellë dhe nga subjekti i rivlerësimit, si dokumentacion justifikues e vërtetues i deklaramenteve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

55.3 Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni më datë 08.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Ndërtimi informal është njëkatësh, por i ngritur mbi sipërfaqen e tokës, pasi zona ku është bërë ndërtimi është një zonë që përmblytet nga uji në pjesën më të madhe të stinës së dimrit. Ndërtimi është bërë me kosto të ulët me material të blerë në treg të lirë, pa faturë shoqëruese të mallit. Është ndërtim me blloqe betoni, dërrasë dhe llaç të bërë vetë, si dhe mbuluar me llamarinë. Sipërfaqja e këtij objekti është kati përdhe me sipërfaqe 100 m² dhe kati i parë me sipërfaqe 120 m². Vlerësimi i koston së ndërtimit të objektit është bërë inxhinieri M. H., sipas së cilit ndërtimi ka një kosto prej 1.462.000 lekësh. Ky ndërtim është bërë me qëllim rritjen e shpendëve dhe tregtimin e tyre. [...] Shtetasi B. H. jeton në fshatin {***}. Ai ka tre fëmijë, vajzën, e cila është martuar me një shtetas shqiptaro-belg dhe jeton në Belgjikë dhe dy djem, ku djali i madh L. H. jeton si emigrant i ligjshëm në Itali që nga viti 2001 dhe djali i dytë M. H., i cili jeton*

së bashku me babain e tij dhe punon që nga viti 2007, fillimisht në komunën {***} e më pas në Bashkinë Shkodër. B. H. ka përfituar tokë sipas ligjit nr. 7501/1991, si dhe jeton me të ardhura të siguruara nga bujqësia dhe blegtoaria, me të ardhura nga puna e djalit të tij në Shkodër, si dhe ndihmohet nga dy fëmijët e tij emigrantë.

Bashkëlidhur përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur:

i) “Preventiv” me objekt “Vlerësimi i punimeve të ndërtimit të objektit ‘{***}’, në fshatin {***}” i punuar nga Inxhinier M. H., sipas të cilit vlera totale e punimeve të ndërtimit të objektit është 1.462.408 lekë;

ii) AMTP-në nr. {***}, sipas të cilës, z. B. H., i jepen 13,530 m² tokë arë në fshatin {***}, si dhe vërtetim i Bashkisë Shkodër, nr. {***} prot., datë 27.01.2020, sipas të cilit, z. M. H., ka qenë me detyrë ndihmës inspektor i mbrojtjes së territorit për periudhën 15.05.2007 e në vazhdim.

55.4 Në përgjigje të pyetësorit drejtuar nga Komisioni më datë 03.03.2020, subjekti i rivlerësimit, pyetjes *Ju keni deklaruar se bashkëshorti juaj ka shpenzuar në vitin 2013 shumën prej 1.400.000 lekësh për një ndërtim informal në fshatin {***}, Shkodër, në të cilin keni deklaruar se ai ushtron aktivitetin privat të shoqërisë “{***}” ShPK. Shpjegoni lidhur me shpenzimet e kryera për investimin e këtij biznesi dhe si janë përballuar ato*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shoqëria “{***}” ShPK është themeluar në datën 02.11.2015, duke pasur si objekt të veprimtarisë së saj rritjen dhe tregtimin e shpendëve [...]. Nëse nga ana juaj kërkohen të dhëna në lidhje me sendet që janë brenda në ndërtesë, sqaroj se fillimisht ndërtimi informal u fillua për rritjen e shpendëve, por më pas u formatua edhe si vend për tregtimin e tyre. Për këtë ai ka vendosur dy frigoriferë të përdorur për të ruajtur shpendët e prerë, një zgarë të ndërtuar nga vjehri im, ka një sobë me gaz të dhënë nga kushëriri S. B., i cili me prishjen e një pjese të lokal “{***}” i ka dhënë bashkëshortit tim një pjesë të pajisjeve të kuzhinës. Sendet e sipërcituara janë blerë në kohë të ndryshme sipas nevojave, konkretisht dy frigoriferët blerë në vitin 2014 dhe 2017, në vlerën 12.000 lekë dhe 10.000 lekë, 6 tavolina dhe karrige për ambientin e brendshëm të blera në vitin 2018 për 48.000 lekë gjithsej, zgara artizanale e cila është bërë falas nga vjehri im, tavolinë kuzhine me material llamarinë, e përdorur, blerë në vitin 2015 në vlerën 10.000 lekë. Në këtë objekt fillimisht ka pasur 6 tavolina me nga dy stola prej dërrase, që kanë kushtuar gjithsej 27.000 lekë. Në këtë vlerë përfshihet vetëm materiali, pasi ato janë bërë nga vetë bashkëshorti. Koha e blerjeve është pasqyruar me afërsi, pasi materialet e blera në treg janë të përdorura dhe shiten pa faturë.*

55.5 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës²¹, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Sa i përket truallit mbi të cilin është ndërtuar ky objekt, deklaroj se fillimisht bashkëshorti ka marrë informacion se kjo sipërfaqe toke është në pronësi “shtet”, por pas verifikimit kjo pasuri rezulton në emër të shtetasit B. A. Pra, trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti për rritjen dhe tregtimin e shpendëve nuk është në pronësi tonën. Kjo marrëdhënie do të rregullohet në të ardhmen me vijimin e procedurave të legalizimit. Në lidhje me mungesën e dokumentacionit justifikues sa i përket kohës së ndërtimit dhe vlerës së investimit, kam deklaruar se ky investim ka përfunduar në korrik të vitit 2013 dhe punimet janë kryer me punëtorë privatë të palicencuar, siç kanë qenë daja i bashkëshortit i quajtur F. H., i cili e ushtron në mënyrë autodidakte profesionin e muratorit dhe që në rastin konkret ka punuar*

²¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa subjekti i rivlerësimit nuk kishte provuar me dokumentacion ligjor provues deklarimet e saj në lidhje me: - pronësinë e truallit mbi të cilin është ndërtuar ky ndërtim; - provimin me dokumentacion ligjor provues në lidhje me kohën e ndërtimit dhe të kostos së investimit (përfshirë edhe arredimin), si dhe vlerën e investimit prej 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekësh, përdorur për këtë ndërtim; - mosdeklarimit të subjektit se ky objekt është përdorur për njësi/lokal.

*në mënyrë vullnetare, si dhe nga M. P., i cili ka punuar dhe ai në mënyrë vullnetare, pasi ka qenë shoku i fëmijërisë së bashkëshortit, siç e kam deklaruar ai nuk jeton më pasi ka gjetur vdekjen gjatë një aksidenti automobilistik. Në këto rrethana, në mungesë të dokumentacionit ligjor që mund të jenë fatura blerjesh dhe fatura shërbimesh, situacione, preventivë, kam paraqitur aktin e vlerësimit të bërë nga eksperti i licencuar M. H. dhe foto të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të objektit. Vetë fakti që bashkëshorti ka bërë kërkesë për legalizim të objektit në datën 19.07.2013, tregon që ndërtimi informal ka qenë i përfunduar në këtë datë, kjo e provuar me dosjen e legalizimit ku është bërë aplikimi për legalizim dhe fotot e objektit të bëra në këtë kohë. Në lidhje me konkluzionin e arritur nga Komisioni, lidhur me përdorimin e këtij objekti për restorant dhe mosdeklarimin e investimit dhe fitimin e realizuar nga ky aktivitet në deklaratën vjetore dhe atë vetting të vitit 2017, sqaroj se destinacioni kryesor ose veprimtaria kryesore e ndërtimit informal është rritja dhe shumimi i shpendëve në kushte natyrale, investimi i bërë në vitet pas 2013 e në vijim, për çdo vit nuk e ka kaluar shumën 500.000 lekë, e cila është ndryshuar më pas në 300.000 lekë, dhe as në këtë vlerë, siç parashikon ligji për deklarimin e pasurive të paluajtshme dhe deklarata e pasurisë, si rrjedhojë, duke qenë në këto rrethana nuk kam vlerësuar se duhet të deklarohen. Në vitin 2015, kur është bërë dhe regjistrimi i shoqërisë “{***}” ShPK në QKB, në këtë vit ka filluar konceptimi i ndërtimit edhe si objekt social-ekonomik, ku përveç rritjes dhe shumimit të shpendëve të bëhej dhe tregtimi i tyre në gjendje të gjallë dhe të gatuar. Ky aktivitet parashikohet specifikisht në objektin e shoqërisë “{***}” ShPK, ku përfshihet edhe hapja e bareve dhe restoranteve.*

56. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioni, pasi ka verifikuar të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se disa prej tyre nuk janë provuar si të vërteta, konstatime që kanë ndikuar vendimmarrjen në raport me këtë pasuri.

Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të kundërshtimit të qëndrimit të Komisionit për sa u përket rrethanave të faktit, të konsideruara ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti, duke analizuar çdo të dhënë e akt shkresor që lidhet me çështjet e veçanta të vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli.

56.1 Trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka deklaruar pronësinë mbi truallin mbi të cilin është ndërtuar në mënyrë informale objekti, pasi nuk e ka pasur në pronësi atë dhe as ajo e as bashkëshorti i saj nuk janë thirrur nga ILDKPKI-ja për të plotësuar këtë pasaktësi dhe nuk është pyetur ndonjëherë nga Komisioni mbi këtë çështje gjatë hetimit, por është pyetur vetëm në rezultatet e hetimit, e pasi ajo deklaroi të dhënat për pronësinë mbi truallin, nga ana e Komisionit nuk iu kërkuan të dhëna të tjera. Trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: 35.2 Deklarimi i subjektit pas kalimit të barrës së provës se për truallin mbi të cilin është ndërtuar ky objekt, fillimisht bashkëshorti ka marrë informacion se kjo sipërfaqe toke është në pronësi “shtet”, por pas verifikimit kjo pasuri rezulton në emër të shtetasit B. A., nuk ishte në përputhje me parashikimet ligjore. 35.3 Trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti për rritjen dhe tregtimin e shpendëve rezultoi se nuk ishte në pronësi të subjektit apo bashkëshortit. Kjo marrëdhënie, e cila do të rregullohej në të ardhmen me vijimin e procedurave të legalizimit, duhet të deklarohet në deklaratën vetting. 10 35.4 Për sa më sipër, edhe mosdeklarimi nga subjekti mbi pronësinë e truallit mbi të cilin ishte ndërtuar ky ndërtim rezulton i bërë në kundërshtim me udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me arsyetimin e bërë nga Komisioni, trupi gjykues vëren se Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, në pikën 9 përcakton: “Deklarimi i pasurive të

paluajtshme në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë këtij institucioni”. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë paraqitur dokumentacionin e dorëzuar pranë ALUIZNI-t Shkodër, dokumentacioni i konfirmuar edhe nga ky institucion në informacionin e përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 29.01.2020, nga AShK Shkodër, si më sipërcituar në këtë vendim. Trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, duke deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ndërtimin informal dhe destinacionin e tij si “jobanesë”, si dhe duke paraqitur dokumentacionin për legalizimin e tij, ka përbushur detyrimin për deklarim, duke mos u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë.

56.2 Për sa i përket vlerës së investimit për ndërtimin informal të objektit “jobanesë”, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, në këtë rast të lidhura ngushtë me vlerën që do të pranohet se ka pasuria “jobanesë”, në fshatin {***}, Shkodër. Ky detyrim buron nga parashikimi i nenit Ç, pika 5 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Këto parashikime ligjore kanë përcaktuar që subjekti i rivlerësimit, dokumentacionin justifikues ligjor të shpenzimeve/investimit të kryer për ndërtimin informal, ta paraqiste së bashku me deklaratën e rivlerësimit në janar të vitit 2017, pra, vetëm rreth tre vjet më vonë nga kryerja e investimit [i përfunduar në vitin 2013]. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit, në pretendimin se nga ana e Komisionit i janë kërkuar dokumente që i përkasin një periudhe mbi 7 vjet përpara, këtë afat e përlllogarit, në mënyrë të gabuar, nga periudha e dërgimit të pyetësorëve nga Komisioni në vitin 2020. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit, që nga viti 2003, ka qenë zyrtar deklarues i interesave private dhe pasurisë në ILDKPKI, për rrjedhojë dokumentimi i investimeve të kryera për ndërtimin informal ka qenë për të një detyrim që në vitin 2013 në të cilin është përfunduar ndërtimi i objektit, detyrim i cili buronte nga parashikimet e ligjit nr. 9049/2003. Por pavarësisht sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur as bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit dhe as përgjatë hetimit administrativ në Komision dokumentacionin justifikues, i cili do të provonte deklaratimet e tij për vlerën e investimit të kryer për ndërtimin e kësaj pasurie. Në kushtet kur kjo pasuri është ndërtuar në mënyrë informale, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të dispozitave të përmendura më lart, kishte detyrimin të provonte vlerën e saj nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit justifikues, i cili do të vërtetonte pagesat e kryera, si dhe të çdo akti shkresor që do të dokumentonte shpenzimet e kryera nga personi i lidhur për ndërtimin e këtij objekti. Akti i vetëm i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, për këtë qëllim, është akti i ekspertimit teknik i hartuar në datën 28.01.2020, prej ekspertit të kontraktuar prej tij, për nevoja të procesit të rivlerësimit. Komisioni, me të drejtë, nuk e ka konsideruar me vlerë provuese këtë aktekspertim, pasi në përmbajtjen e tij, vetë akti, i cili është paraqitur në formën e një preventivi të thjeshtë punimesh, nuk paraqet asnjë shpjegim mbi mënyrën e përlllogaritjes së kostove, pasi nuk detajon e as përcakton volumet e punës së konstatuara në banesë, cila është baza ligjore dhe cilat janë referencat e përdorura në përlllogaritjen e shumave për secilin prej zërave të preventivit, si dhe në kushtet kur është hartuar rreth 7 vjet më vonë nga periudha e ndërtimit, nuk garanton se kostot e përcaktuara në të janë konkluzion i një analize të gjithanshme, e cila do të krijonte besueshmëri për vlerën respektive të kostos për çdo zë punimesh, në kohën e ndërtimit të objektit. Përtej faktit që preventivi është hartuar në përgjigje të kërkesave apo fakteve të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit dhe të pacertifikuara nga ndonjë autoritet publik, por në funksion të procesit të rivlerësimit, madje në një fazë të avancuar të tij, në përgjigje të gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, çmohet se është kryer për nevoja të evidentimit të sforcuar të vlerës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Gjithashtu, mbeten të pambështetura në prova edhe përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të justifikuar shpenzimet e kryera për krahun e punës,

duke i paraqitur ato si të kryera në mënyrë vullnetare, nga të afërm e miq të bashkëshortit. Në këtë vlerësim të mungesës së besueshmërisë të fakteve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i dha një peshë të rëndësishme edhe qëndrimin të mëpasshëm, kontradiktor, të saj në ankim, në të cilin ka pretenduar një vlerë të re prej 1.051.996 lekësh, si vlerë të investimit për ndërtimin informal, e rezultuar kjo nga një akt i ri ekspertimi i hartuar nga një ekspert tjetër i kontraktuar prej saj, dukshëm më e ulët, sesa vlera e pretenduar gjatë hetimit administrativ në Komision e sesa vlera e deklaruar në deklarimet pranë ILDKPKI-së. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerësoi se vlera e investimit të ndërtimit informal, në shumën 1.400.000 lekë, e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në dritën e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, e prezantuar në dy versione kontradiktore, duke qenë se nuk u mbështet me dokumentacion provues apo të dhëna nga burime të njohura, sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbetet një e dhënë, e cila nuk mund të verifikohet e që nuk krijon besueshmëri për ekzistencën e saj, për t'u përdorur si referim për vlerën e investimit të ndërtimit informal në fshatin {***}.

56.3 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka përcaktuar vlerën absurde prej 6.638.720 lekësh, si vlerë investimi sipas EKB-së, pa arsyetuar dhe analizuar sesi ka dalë kjo vlerë, pa dhënë referencë konkrete se cilit vit të çmimeve të EKB-së i është referuar, si dhe ka llogaritur objektin dykatësh, ndërkohë që ai është njëkatësh, trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit të Komisionit, vëren se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, Komisioni, ka arsyetuar: *34.6 Lidhur me koston e deklaruar nga subjekti për ndërtimin e këtij objekti në vlerën 1.400.000 lekë, duke qenë se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë preventiv apo situacion punimesh, Komisioni iu referua çmimeve të EKB-së, për periudhën e investimit, sipas të cilave vlera e investimit do të ishte 6.638.720 lekë. Me detajet e përlllogaritjes së kësaj vlere, subjekti i rivlerësimit është njohur në rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat ka referuar se lidhur me koston e deklaruar nga subjekti për ndërtimin e këtij objekti në vlerën 1.400.000 lekë, duke qenë se ai nuk ka paraqitur ndonjë preventiv apo situacion punimesh të kohës së ndërtimit, Komisioni iu referua çmimeve të EKB-së, por për periudhën e investimit zona e referencës ishte vetëm qyteti i Shkodrës dhe jo rrethina të tjera apo {***}. Vlera e investimit, duke u bazuar në Udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, nga EKB (i vlefshëm edhe për vitin 2012) do të ishte $30.176 \text{ lekë/m}^2 \times 220 \text{ m}^2 = 6.638.720 \text{ lekë}$. Nga sa më sipër, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit është njohur me mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni të vlerës së investimit në shumën prej 6.638.720 lekësh.*

Për sa i përket pretendimit tjetër të subjektit se Komisioni ka llogaritur objektin dykatësh, ndërkohë që ai është njëkatësh dhe i ngritur nga toka me bazament me blloqe betoni, trupi gjykues vëren se Komisioni, në kushtet kur procesi i legalizimit ende nuk është përfunduar, në llogaritjen e sipërfaqes së ndërtimit informal, është bazuar në vetëdeklarimin e personit të lidhur, z. G. A., në formularin e kërkesës për legalizim, nr. {***} prot., datë 19.07.2013, në të cilën ai ka deklaruar të dhënat: Ndërtim pa leje “Jobanesë”, në adresën Fshati {***}, Komuna {***}, Shkodër, sipërfaqe e bazës së ndërtimit pa leje 100 m^2 , sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit pa leje 220 m^2 , numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë s’ka, funksioni i ndërtimit “Për rritje shpendësh”, sipërfaqja e truallit të ndërtimit pa leje $1,000 \text{ m}^2$.

Nga verifikimi i dokumentacionit të prodhuar për efekt të procesit të legalizimit, përcjellë në Komision nga AShK Shkodër, nga të dhënat e planit të rilevimit të objektit informal, rezulton se ai përbëhet nga kati i parë dhe nga kati përdhe, i cili ka plinta e kolona për të mbajtur katin e parë. Edhe nga verifikimi i fotove të objektit informal, që shoqërojnë dokumentacionin e sipërcituar, objekti informal duket i përbërë nga dy kate, kati i parë me mure të suvatuara e hapësira të dritareve bosh i destinuar për rritjen e shpendëve, ndërsa kati i dytë me dyer e dritare dhe ballkone me muret e suvatuara e një pjesë edhe të veshura me dru, që duket i përshtatshëm për banim apo për ushtrimin e aktivitetit restorant, të pretenduar prej vetë subjektit të rivlerësimit.

Nga preventivi i punimeve, i hartuar nga eksperti i kontraktuar nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë se për ndërtimin e objektit janë pasqyruar të dhënat: germim dheu, plinta e themel; mure guri themel; betonim i plintave; ndërtim trarë; ndërtim kolona; soletë beton arme; ndërtim mure blloku betoni; hekur betoni; shtresë zhavorri; shtresë betoni; suvatim i jashtëm; dysheme dërrase mbi konstruksion metalik; ndërtim çati me konstruksion metalik; parapet metalik për shkallë e ballkone; dhe punime hidrosanitare e elektrike.

Në këto kushte, trupi gjykues, duke vlerësuar të gjitha të dhënat që rezultojnë nga burime të njohura e të besueshme e duke i analizuar ato në harmoni e në raport me njëra-tjetrën, në përputhje me parashikimin ligjor të nenit 49, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, krijon bindjen e bazuar se ky objekt përbëhet nga dy kate.

Pavarësisht analizës si më sipër, duke konsideruar se:

- i) subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion vlerën e investimit të kryer në kohën e ndërtimit të objektit informal, megjithëse bëhet fjalë për një periudhë të afërt trevjeçare nga momenti i ndërtimit deri në momentin e deklarimit të pasurisë, për efekt të procesit të rivlerësimit;
- ii) nga fotot dhe nga të dhënat e planit të rilevimit të objektit, dokumente që gjenden në dokumentacionin e hartuar për efekt të procesit të legalizimit të objektit e që i përkasin vitit 2016 e, për pasojë, janë dokumentet më të afërta me kohën e pretenduar se kanë përfunduar punimet e ndërtimit, [korrik 2013], nga të cilat, megjithëse objekti informal rezulton se përbëhet nga dy kate, vetëm njëri prej tyre duket se është i përshtatshëm për ushtrim aktiviteti socio-ekonomik, ndërsa kati përdhës ka formë të ngjashme me një ambient për rritjen e shpendëve/kafshëve, të cilit i mungojnë elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar;
- iii) kati i parë, [i dytë i ndërtimit], është i mbuluar me një çati me konstruksion metalik mbuluar me llamarinë;

trupi gjykues vlerësoi se këtij ndërtimi, në tërësi, i mungojnë disa elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar të tipit banesë, për të cilat EKB-ja, në bazë të udhëzimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, përcakton çmimet referuese. Në këtë këndvështrim, duke e vlerësuar objektin për nga pikëpamja strukturore, sipas të dhënave të referuara nga agjencia shtetërore e të dala nga kontrolli i kryer në objekt për efekt të procesit të legalizimit, trupi gjykues çmoi të konsiderojë investimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit e personi i lidhur, më së paku, në nivelin e ndërtimit të karabinasë, e cila është një strukturë e njëjtë në të gjitha llojet e ndërtesave²², sipas përkufizimit të dhënë në nenin 12/1 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar²³: “*Karabina*” është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën e plotë të objektit.

Për pasojë, në referencë të qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji në disa vendime të dhëna prej tij rreth koston së një objekti të ndërtuar deri në fazën e karabinasë, që varion në një raport nga 40-42% e çmimit referues të përcaktuar nga EKB-ja, si dhe në kushtet kur pasuria objekt kontrolli është një ndërtim informal²⁴, vlera e investimit për ndërtimin e objektit informal në fshatin {***}, Shkodër, u përllogarit në shumën 2.655.488 lekë, në raportin 40% të vlerës prej 6.638.720 lekësh²⁵,

²² Neni 3 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi në kohën e përfundimit të ndërtimit informal, parashikonte se: “Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera”.

²³ Me ndryshimet e miratuara të tij, deri në datën 13.02.2013.

²⁴ Në koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja nuk përfshiheshin vlerat e: 1. rrjetit inxhinierik; 2. projektit; 3. studimit gjeologjik dhe sizmik; 4. lejes së ndërtimit; 5. Truallit; 6. shpenzime operationale të EKB 4%.

²⁵ Me mënyrën e përllogaritjes së kësaj vlere, subjekti i rivlerësimit është njohur gjatë hetimit administrativ në Komision: $30.176 \text{ lekë/m}^2 * 220 \text{ m}^2 \text{ sipërfaqe ndërtimi deklaruar nga vetë personi i lidhur} = 6.638.720 \text{ lekë}$.

e cila rezultonte të ishte vlera e përlllogaritur bazuar në Udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”.

Trupi gjykues nënvizon faktin se vlera e investimit, e përlllogaritur si më sipër, është një vlerë objektive dhe e arsyeshme, pasi kostot mesatare të ndërtimit të përcaktuara nga EKB-ja vlejné edhe për ndërtimet “jobanesë” në rastin konkret, pasi në fazën e ndërtimit “karabina”, punimet e kryera të ndërtimit janë të njëjta në të gjitha llojet e ndërtesave, “banesa” ose “jobanesa”, siç edhe rezultojné të përshkruara në aktet e sipërcituara të depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit²⁶.

Në konkluzion të kësaj analize, mbështetur në arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues arriti në përfundimin se shuma prej 2.655.488 lekësh do të duhet të konsiderohet si vlera e shpenzuar, më së paku, për ndërtimin e objektit dhe duhet të përfshihet në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme, të përdorura për krijimin e kësaj pasurie.

Trupi gjykues shqyrtoi dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk e ka të qartë se çfarë ka pasur parasysh Komisioni, duke u shprehur për vlerën e investimit që i ka rritur vlerën objektit, pasi objekti ka qenë në të njëjtën gjendje ndërtimore që në momentin që është deklaruar për legalizim, ndërsa investimi i mëvonshëm konsiston në blerjen e karrigeve dhe tavolinave të përdorura dhe në blerjen e pajisjeve modeste të kuzhinës, pasi konceptimi si objekt social-ekonomik ka ndodhur në vitin 2015, kur është krijuar prej bashkëshortit të saj shoqëria “{***}” ShPK. Në kuadër të këtij shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni gjatë hetimit administrativ²⁷ i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e investimit për ndërtimin informal, si dhe për shpenzimet e bëra për arredimin e tij. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka detajuar shpenzimet e kryera për blerjen e pajisjeve të nevojshme si pajisje kuzhine, karrige e tavolina, për ta bërë objektin funksional në përmbushje të objektit të aktivitetit të shoqërisë “{***}” ShPK. Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se shpenzimet e kryera nga bashkëshorti i saj në vite janë në shumën totale prej 107.000 lekësh²⁸. Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka arsyetuar se cilat janë investimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, të cilat i kanë shtuar vlerën objektit dhe në cilin dokumentacion është bazuar për të provuar kryerjen e këtyre investimeve nga subjekti i rivlerësimit. Edhe në analizën financiare përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk ka vendosur zëra/vlera për sa i përket investimeve të kryera për të rritur vlerën e ndërtimit informal. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, që në fazën e njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, ka qenë i qartë për mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni të vlerës së ndërtimit të objektit informal, e cila duke u përlllogaritur sipas kostos së ndërtimit sipas EKB-së për m² në raport me sipërfaqen e ndërtimit, nuk përfshinte në të investimet e mëvonshme të kryera nga personi i lidhur. Për më tepër, Komisioni, në vendim, ka arsyetuar në vijimësi²⁹, për përlllogaritjen e kostos në momentin e ndërtimit të objektit informal,

²⁶ Sipas preventivit të paraqitur gjatë hetimit administrativ listohen si punime te kryera: gërmim dheu, plinta e themel; mure guri themel; betonim i plintave; ndërtim trarë; ndërtim kolona; soletë beton arme; ndërtim mure blloku betoni; hekur betoni; shtresë zhavorri; shtresë betoni; suvatim i jashtëm etj.

²⁷ Në pyetësorin drejtuar subjektit të rivlerësimit më datë 03.03.2020 – shih paragrafin 56.4 më sipër në këtë vendim.

²⁸ Sipas subjektit të rivlerësimit shpenzimet janë kryer për: dy frigoriferët blerë në vitin 2014 dhe 2017, në vlerën 12.000 lekë dhe 10.000 lekë, 6 tavolina me nga dy stola prej dërrase, që kanë kushtuar gjithsej 27.000 lekë, 6 tavolina dhe karrige për ambientin e brendshëm të blera në vitin 2018 për 48.000 lekë gjithsej, tavolinë kuzhine me material llamarinë, e përdorur, blerë në vitin 2015 në vlerën 10.000 lekë.

²⁹ Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: “35.12 Komisioni nuk e ka konsideruar me vlerë provuese aktekspertimin nga inxhinier M. H. përtej faktit që është hartuar, në përgjigje të kërkesave apo fakteve të paraqitura prej subjektit dhe të pacertifikuara nga ndonjë autoritet publik, por edhe sepse në brendinë e tij, akti nuk garanton se kostot e përcaktuara në të janë konkluzion i një këqyrjeje të plotë dhe analize të gjithanshme, e cila do të krijonte një panoramë të besueshme për çdo zë punimesh e vlerë respektive të kostos. 35.13 Në këto rrethana, trupi gjykues konsideron se ky aktekspertimi, i hartuar mbështetur në këto elemente, nuk mund të përdoret si referim për vlerën e kësaj pasurie. 35.14

duke analizuar se të dhënat e paraqitura gjatë hetimit nuk ishin të besueshme për vlerën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e objektit, pa i dhënë vlerë e pa i përfshirë investimet e mëvonshme në koston e ndërtimit të objektit informal.

Lidhur me destinacionin e këtij objekti, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në kërkesën për legalizim ka deklaruar se ndërtimi informal është “jobanesë”, ndërsa në planin e rilevimit të hartuar nga ekspertët përkatës objekti rezulton të jetë cilësuar si “objekt socio-ekonomik”. Në deklaratën e interesave të vitit 2013, personi i lidhur e ka deklaruar objektin si “jobanesë”, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar se ndërtimi informal ka shërbyer për rritjen e shpendëve dhe se në kohën e deklarimit ka qenë pa aktivitet. Edhe nga informacioni i përcjellë në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve³⁰ rezultoi se shoqëria “{***}” ShPK, në vitet e ushtrimit të aktivitetit 2015, 2016 e në vijim, ka rezultuar me humbje dhe shpenzimet e kryera kanë konsistuar në blerje shpendësh dhe ushqim për to, si dhe në paga personeli. I njëjti informacion është konfirmuar edhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër³¹.

Në këto kushte, trupi gjykues nuk e gjen të bazuar në fakte konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investimet e kryera ndër vite dhe nuk ka deklaruar destinacionin e këtij objekti si bar-restorant, sipas parashikimeve të shkronjës “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

56.4 Në vijim, trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat ai kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me burimin e ligjshëm të huas të marrë nga z. B. H., në shumën 600.000 lekë, e përdorur si burim krijimi për ndërtimin e objektit informal, në fshatin {***}, duke pretenduar se ka paraqitur prova se kjo hua, (e shlyer plotësisht nga subjekti i rivlerësimit), është krijuar prej huadhënësit me burime të ligjshme. Trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se: *36.8 Duke marrë në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit, shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, nuk mund të konsiderohen si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. [...]. 36.11 Referuar deklaratimeve të subjektit nuk u provua me dokumentacion ligjor provues prej saj mundësia financiare e shtetasit B. H. për të mbuluar huan me burime të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.* Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me arsyetimin e mësipërm të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion, me qëllim që të provonte faktin se z. B. H. është huadhënës për shumën prej 600.000 lekësh, dhënë bashkëshortit të saj në vitin 2013, pasi z. B. H., në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka konfirmuar dhënien e huas në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.03.2015. Subjekti i rivlerësimit, në përmbushje të detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga z. B. H., ka paraqitur AMTP-në nr. {***}, sipas të cilit ky i fundit ka përfituar sipërfaqe tokë arë, në bazë të ligjit nr. 7501/1991, si dhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 27.01.2020, të Bashkisë Shkodër, sipas të cilit z. M. H. është i punësuar pranë këtij institucioni. Nga ky dokumentacion nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me të ardhurat e realizuara nga z. B. H. apo nga djali i tij, z. M. H., në mënyrë që të mund të vlerësohet nëse ata kishin mundësi që nga të ardhura të ligjshme të jepnin hua shumën prej 600.000 lekësh, në vitin 2013. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka

Referimi te kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar nda EKB-ja, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi dhe sipas vlerës së këtij referimi, përafërsisht 6,000,000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar ndërtimin informal.”

³⁰ Informacioni i përcjellë në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.07.2019, nga DPT-ja.

³¹ Informacioni i përcjellë në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.02.2020, nga DRT-ja Shkodër.

plotësuar detyrimin e vendosur nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*

Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se z. B. H. ka pasur mundësi që t'i jepte hua shumën prej 600.000 lekësh, mbetet i pambështetur në dokumentacion provues, për pasojë i pabazuar.

57. Duke përdorur konkluzionet e arritura në këtë arsyetim, që lidhen me: (i) periudhën e ndërtimit të objektit informal në fshatin {***}, në periudhën 01.01.2013-19.07.2013, në kushtet kur kjo periudhë është konsideruar nga Komisioni, në përputhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe nuk është kundërshtuar prej tij në ankim; (ii) përlllogaritjen e vlerës e kostos së ndërtimit të objektit në shumën prej 2.655.488 lekësh; (iii) njohjen si jo të ligjshme të shumës prej 600.000 lekësh, dhënë hua nga z. B. H., në vitin 2013; (iv) nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për periudhën 01.01.2013-19.07.2013, rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një balance negative për kryerjen e shpenzimeve për ndërtimin e objektit informal, në shumën 2.119.961 lekë.
58. Në këndvështrim të pretendimeve të subjektit të parashtruara në ankim, trupi gjykues vlerësoi që në një version garantist, hipotetikusht, t'ia nënshtrojë analizës financiare, vlerën prej 1.400.000 lekësh të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit e personi i lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si vlerë e investimit për ndërtimin e objektit informal në fshatin {***}, me qëllim kontrollin e afektimit të mungesës së burimeve të ligjshme të subjektit e personit të lidhur. Referuar analizës financiare të kryer si më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit në shumën 864.473 lekë, referuar kostos së ndërtimit, sipas asaj të deklaruar nga vetë subjekti.
59. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se, në të gjitha versionet e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ndërtimin informal në fshatin {***}, Shkodër, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
60. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *konkluzioni i Komisionit, se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga qiraja derdhur nga shoqëria “{***}” ShA gjatë periudhës 2008-2012, është një konkluzion i qëllimshëm dhe një përpjekje për të keqinterpretuar provat në justifikim të një vendimi të pabazuar*, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: *37.12 Shpjegimi i subjektit se për periudhën 2008-2012, bashkëshorti i saj nuk ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie dhe se kjo llogari ka shërbyer vetëm për depozitimin e shumës së qirasë nga “{***}” ShA dhe tërheqja e shumave është bërë në bankomate, duke ia dorëzuar në vijim pronarit Gj. P., nuk mbështetet në asnjë fakt dhe provë dhe nuk provohet nga verifikimi i TIMS, sipas të cilit Gj. P. nuk ka qenë në Shqipëri nga data 18.05.2010. 37.13 Pretendimi i subjektit se kjo vlerë i është kthyer shtetasit Gj. P. nuk provohet nga asnjë dokumentacion ligjor provues. Këto depozitime në llogarinë bankare, për periudhën 2008-2012, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike përkatëse dhe as në deklaratën vetting, në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. [...] Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte shumat e kaluara në llogarinë bankare të personit të lidhur gjatë viteve 2008-2012, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 11, të nenit 3, neneve 30-32 dhe të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. 37.17 Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë*

së rivlerësimit, duke mos i deklaruar këto likuiditete, në kundërshtim me parashikimet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

61. Në shkakun e ankimit, në kundërshtim të arsyetimit dhe konkluzionit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar, si vijon:

*i) Provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, se për periudhën 2008-2012, bashkëshorti i saj nuk ka përfituar të ardhura nga qiraja nga shoqëria “{***}” SHA, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, me dokumentacionin e paraqitur, ka provuar se qiratë e paguara nga shoqëria “{***}” ShA për këtë periudhë janë derdhur në llogarinë bankare të bashkëshortit të saj, por nuk janë përfituar nga ai, pasi kjo llogari ka shërbyer vetëm për depozitim të shumës së qirasë nga shoqëria në fjalë dhe tërheqja e shumave është bërë në bankomate, duke ia dorëzuar në vijim pronarit Gj. P..*

ii) Subjekti i rivlerësimit nuk është vënë në dijeni nga Komisioni, lidhur me faktin e cituar në vendim se nga sistemi TIMS provohet se z. Gj. P. nuk ka qenë në Shqipëri nga data 18.05.2010. Nga Komisioni është përdorur një provë me të cilën subjekti nuk është njohur dhe nuk i është dhënë mundësia ta interpretojë apo të paraqesë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, duke shkelur kështu parimin kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

*iii) Komisioni, në vendim, në mënyrë të qëllimshme apo nga mosnjohja e materialeve të dosjes, ka cituar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm vlerën 240.000 lekë për vitin 2014 nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “{***}” ShA, ndërkohë që subjekti ka deklaruar edhe vlerën 440.000 lekë të përfituar gjatë vitit 2013.*

62. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, pas verifikimit të akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si vijon.

62.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar *të ardhura nga aktiviteti privat si agjent sigurimesh pranë kompanisë “{***}” dhe nga kontrata e qirasë me këtë kompani për vitin 2013 dhe nga muajt mars-tetor 2014, për objektin të marrë me qira nga shtetasi Xh. P. 440.000 lekë në vitin 2013 dhe 240.000 lekë në vitin 2014.*

62.2 Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues:

*a) deklaraten nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2015, të z. Gj. P., i cili deklaroi se i ka dhënë me qira shtetasit G. A., pasurinë e llojit ndërtesë, me nr. pasurie {***}, në ZK {***}, me sipërfaqe 73,6 m², në sheshin “{***}”, nga kjo pasuri vetëm 8,75 m², kundrejt shumës 5.000 lekë/muaj, për periudhën janar 2013 deri më 30.03.2015;*

*b) vërtetimin, datë 05.03.2015, të shoqërisë “{***}” ShA, me lëndë: “Vërtetim për pagesat e qirasë”, sipas të cilit “{***}” ShA, dega Shkodër ka pasur një marrëdhënie qiramarrjeje me z. G. A., për një zyrë me adresën në sheshin “{***}” dhe për vitin 2013, për periudhën janar-nëntor 2013, shoqëria ka paguar një total prej 440.000 lekësh, me një vlerë 40.000 lekë/muaj. Për vitin 2014 “{***}” ShA ka pasur një kontratë qiraje për periudhën mars-tetor 2014 dhe është paguar në total 240.000 lekë, me një vlerë 30.000 lekë/muaj;*

*c) nxjerrje e llogarisë bankare të z. G. A. në “Raiffeisen Bank”, për vitet 2013 dhe 2014, në të cilat figurojnë derdhjet e shumave të qirasë në muajt e cituar në vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA.*

62.3 Në deklaratën e interesave private të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar të ardhura të përfituara nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “{***}” ShA.

62.4 Në deklaratën e interesave private të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar të ardhurat nga kompania {***}, për periudhën mars 2014-tetor 2014, kontratë e përfunduar në muajin tetor të vitit 2014. Vlera: 240.000 lekë.

62.5 Në pyetësonin drejtuar subjektit të rivlerësimit në datën 08.01.2020, Komisioni ka kërkuar shpjegime lidhur me “Pse nuk keni deklaruar qiranë prej 2.000.000 lekësh? Paraqisni dokumentacion provues lidhur me pagimin e tatimeve dhe paraqisni dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar ligjshmërinë e kontratës së qirasë”. Në shpjegimet për sa më sipër, subjekti ka deklaruar: “Për qiranë për vitet 2008-2012, nuk kam pasur dijeni, por sipas komunikimit me bashkëshortin tim, i cili në këto vite ka qenë në marrëdhënie pune në komunën {***}, Shkodër, zyra i është marrë me qira nga “{***}” ShA, shtetasit Gj. P. dhe është menaxhuar nga punonjës të kësaj shoqërie. Për këtë periudhë, qiraja i është paguar në dorë qiradhënësit Gj. P. nga personat të cilët kanë punuar për llogari të shoqërisë “{***}” ShA. Shoqëria “{***}” ShA ka përdorur llogarinë e bashkëshortit tim për të depozituar vlerën e qirasë për objektin e marrë me qira nga shtetasi Gj. P., pasi ky shtetas në atë kohë ka deklaruar se nuk ka pasur llogari bankare dhe ka qenë bashkëshorti im, i cili fillimisht ka dashur që ta marrë për vete me qira objektin, duke qenë se është i njëjti objekt i marrë më parë me qira nga kompania “{***}”, por duke qenë se bashkëshorti im filloi punë në Komunën {***}, Shkodër [...] këto rrethana bënë të pamundur marrjen me qira të kësaj zyre dhe duke qenë se në atë kohë kompania “{***}” kërkonte zyrë me qira për agjentët e vet, ai ka biseduar me shtetasin Gj. P. për t’ia lëshuar zyrën me qira kësaj shoqërie, ndërkohë llogaria bankare mbeti e hapur dhe me qëllimin se po të largohej nga puna në komunë të rikthehej në këtë zyrë. Pra, ky numër llogarie në emër të bashkëshortit tim ka shërbyer thjesht si depozitë parash nga shoqëria “{***}”, të cilat më pas i janë dorëzuar pronarit të objektit. Tërheqja në bankomat dhe dorëzimi i shumës së qirasë për këtë periudhë është bërë kryesisht nga ish-agjenti i “{***}”, I. H.. Duke qenë se bashkëshorti im nuk ka pasur asnjë marrëdhënie qiraje apo punësimi me këtë shoqëri për këtë periudhë dhe nuk ka siguruar asnjë të ardhur, nuk e ka deklaruar këtë shumë duke e vlerësuar si një shumë që nuk i përket atij. Pra, nga ana e tij nuk ka qenë qëllimi që të mos deklarohen këto të ardhura, pasi nuk kanë qenë të ardhura të destinuara për të, por për qiradhënësin Gj. P., aq më tepër që për të gjithë periudhën e sipërcituar, sipas informacionit të ardhur nga “{***}” ShA, është paguar tatimi në burim nga vetë shoqëria”.

62.6 Bashkëlidhur përgjigjes së sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin në vijim.

a) deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2020, e z. J. P., i cili ka deklaruar se babai i tij ka në pronësi objektin e ndodhur në sheshin “{***}” dhe për vitet 2008-2012 ia ka dhënë me qira shoqërisë “{***}” ShA. Kontrata është lidhur verbalisht. Qiraja i është dorëzuar babait të tij nga shtetasi I. H., i cili ka përdorur këtë zyrë;

b) vërtetimin, datë 22.01.2020, i nënshkruar nga z. R. D., shëf i Administratës së shoqërisë “{***}” ShA, i cili vërteton se në arkivën e shoqërisë “{***}” ShA, për vitet 2008 deri në vitin 2014, kontratat e qirasë për një zyrë në pronësi të z. G. A., janë si më poshtë: Për vitet 2008 dhe 2009 nuk gjenden si pasojë e ndryshimeve në pronësi dhe të transferimeve me zyra. Për vitet 2010, 2011, 2012 regjistrimi i kontratave është në librin e protokollit, por nuk gjenden fizike. Për vitet 2013 dhe 2014 janë bashkëngjitur materialit edhe kontratat fizike;

c) deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2020, të z. I. H., i cili ka deklaruar se [...] kam pasur në përdorim objektin në pronësi të shtetasit Gj. P. për vitet 2008-2012, ku kjo zyrë është marrë me qira nga “{***}” ShA. Për këtë periudhë unë jam marrë me menaxhimin e zyrës. Qiraja, e cila është derdhur nga “{***}” ShA në llogarinë e shtetasit G. A. dhe është tërhequr prej meje, i është dorëzuar shtetasit Gj. P. (Xh.).

62.7 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezulton se shoqëria “{***}” ShA, me shkresë nr. {***} prot., datë 23.01.2020, ka përcjellë informacionin se shoqëria “{***}” ShA me shtetasin G. A., gjatë periudhës 2008-2014 ka qenë në marrëdhënie kontraktuale qiramarrjeje. Në bazë të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit, ndër vite, janë kryer pagesat e poshtëshënuara në favor të shtetasit G. A., për ambientin zyrë të marrë në përdorim nga shoqëria “{***}” ShA: janar 2008-dhjetor 2008, në vlerë totale 198.000 lekë; janar 2009-dhjetor 2009, në vlerë totale 533.328 lekë; janar 2010-dhjetor 2010, në vlerë totale 533.328 lekë; janar 2011-dhjetor 2011, në vlerë totale 533.328 lekë; janar 2012-dhjetor 2012, në vlerë totale 533.328 lekë; janar 2013-dhjetor 2013, në vlerë totale 533.328 lekë; si dhe janar 2014-tetor 2014 në vlerë totale 266.664 lekë. Për qiranë si më sipër, tatimi në burim është paguar nga subjekti “{***}” ShA.

Shoqëria “{***}” ShA ka paraqitur edhe kontratat e qirasë të lidhura me z. G. A., përkatësisht, kontratë qiraje nr. {***} prot., datë 31.12.2013 dhe kontratë qiraje nr. {***} prot., datë 21.03.2014.

62.8 Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se duket se subjekti nuk i ka deklaruar të ardhurat e qirave të transferuara në llogaritë bankare të bashkëshortit nga kompanitë e sigurimeve “{***}” ShA dhe “{***}” ShA, për periudhën 2008-2012. Duke qenë se bashkëshorti i subjektit i ka marrë në llogaritë bankare të tij këto të ardhura nga qiraja, ai duhet t’i deklaronte edhe në DPV edhe në vetting. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se [...] referuar vërtetimit të lëshuar nga “{***}” ShA më datë 23.01.2020, për vitet 2013 dhe 2014 shumat janë më të mëdha dhe për këto dy vite mendoj se duhet të merren vlerat e përcaktuara në këtë vërtetim.

63. Në analizë të sa më sipër konstatuar, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

63.1 Lidhur me pretendimin e subjektit se provat e paraqitura prej saj, që për periudhën 2008-2012, bashkëshorti i saj nuk ka përfiturar të ardhura nga qiraja nga shoqëria “{***}” ShA, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, trupi gjykues, pasi verifikoi rezultatet e hetimit administrativ dhe vendimin e Komisionit, vëren se Komisioni i ka analizuar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, por nuk i ka gjetur ato me vlerë provuese në raport me pretendimet e tij. Të dhënat e referuara në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2015, të z. Gj. P., deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2020, të z. J. P. dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2020, e z. I. H., përveçse me fuqi të kufizuar provuese, pasi janë lëshuar për efekt të procesit të rivlerësimit³², janë në kundërshtim edhe me faktet e referuara në vërtetimet e shoqërisë “{***}” ShA, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit. Sipas vërtetimeve të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShA, [njëri prej tyre i paraqitur si provë nga vetë subjekti i rivlerësimit], kjo shoqëri ka qenë në marrëdhënie kontraktuale qiramarrjeje me z. G. A. që prej vitit 2008. Edhe nga nxjerrja e llogarisë së z. G. A. në “Raiffeisen Bank” rezulton se shumat e qirasë i janë derdhur në këtë llogari rregullisht, për periudhën 2008-2014. Argumenti i vetëm i subjektit të rivlerësimit se llogaria e bashkëshortit të saj është përdorur thjesht për derdhjen e qirasë, pasi z. Gj. P. nuk kishte llogari bankare, nuk është e besueshme, pasi në optikën e trupit gjykues, hapja e një llogarie bankare është një veprim i thjeshtë bankar, i mundshëm nga kushdo që është person madhor, me zotësi për të vepruar dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë pse z. P. nuk ishte në kushtet e kryerjes së një veprimi të tillë. Subjekti

³² Në vijim të jurisprudencës së Kolegjit, deklaratat noteriale e kryer gjatë procesit të rivlerësimit, ka vlerë të kufizuar për sa i përket provueshmërisë së faktit që kërkon të provojë, duke qenë se është konsideruar si një përpjekje e subjektit, e diktuar nga nevoja për të justifikuar një situatë të konstatuar nga hetimi.

i rivlerësimit nuk ka paraqitur argumente bindëse, të shoqëruara me dokumentacion provues, se përse bashkëshorti i saj, në kundërshtim me sa vërteton qiramarrësi, nuk i ka përfituar shumat e qirasë për vitet 2008-2012, por i ka përfituar ato vetëm për vitet 2013 dhe 2014, në kushtet kur nuk duket të ketë pësuar ndryshime pronësia e ambientit objekt qiraje dhe duket se z. P. për këto vite ka pranuar të ulen fitimet e tij nga marrëdhënia e qirasë, pasi qiraja që personi i lidhur i paguante z. P. ishte shumë herë më e ulët sesa ajo që ky i fundit përfitonte nga marrëdhënia e pretenduar me shoqërinë “{***}” ShA. Trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, që tenton t’ia atribuojë z. Gj. P. marrëdhënien e qirasë me shoqërinë “{***}” ShA për periudhën 2008-2012, bie ndesh me provat e paraqitura nga vetë subjekti, si dhe argumentet e dhëna prej saj nuk krijojnë bindjen se marrëdhënia e qirasë mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShA të ketë qenë vetëm në periudhën e pretenduar 2013-2014, sa kohë që ato nuk mbështeten nga të dhëna të tjera që rezultojnë nga dokumentacioni ligjor i krijuar në mënyrë autonome e jashtë ndikimit të procesit të rivlerësimit.

63.2 Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se nuk është vënë në dijeni nga Komisioni lidhur me faktin e cituar në vendim se nga sistemi *TIMS* provohet se z. Gj. P. nuk ka qenë në Shqipëri nga data 18.05.2010. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni është përdorur një provë me të cilën ajo nuk është njohur dhe nuk i është dhënë mundësia ta interpretojë apo të paraqesë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, duke shkelur kështu parimin kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Në analizë të të gjitha të dhënave që ndodhen në dosjen e rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, trupi gjykues evidentoi se nuk gjenden të dhëna nga sistemi *TIMS* për z. Gj. P. dhe Komisioni, në pyetësorët drejtuar subjektit dhe në rezultatet e hetimit administrativ, nuk e ka njohur atë me faktin e cituar në vendim se nga sistemi *TIMS* provohet se z. Gj. P. nuk ka qenë në Shqipëri nga data 18.05.2010. Pavarësisht nga sa më sipër, trupi gjykues, nga kontrolli i vendimit të Komisionit, vëren se fakti i kundërshtuar nga subjekti, për shkak të mosnjohjes me të, nuk është argumenti i vetëm dhe as argumenti kryesor mbi të cilin Komisioni ka mbështetur arsyetimin e tij, në mënyrë që mosnjohja e subjektit të rivlerësimit me të të vinte në diskutim vendimmarrjen e Komisionit, për shkak të cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor.

63.3 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se nga Komisioni i janë konsideruar vetëm të ardhurat e deklaruar nga qiraja në vitin 2014 dhe jo ato të vitit 2013, trupi gjykues konstatoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike të interesave të vitit 2013, nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “{***}” ShA. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues çmoi se Komisioni duhet të kishte ballafaquar pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të dhënat e rezultuara nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit, dokumentacioni bankar, vërtetimet e lëshuara nga shoqëria “{***}” ShA, si dhe përmbajtja e kontratës së qirasë nr. {***} prot., datë 31.12.2013, lidhur mes z. G. A. dhe shoqërisë në fjalë, nga të cilat vërtetohet se personi i lidhur ka përfituar të ardhura nga qiraja, shumë prej 440.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

64. Në përfundim, ndonëse konstatoi se vlera e përfituar nga qiraja në vitin 2013 duhet të kishte gjetur pasqyrim në analizën financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve për vitin 2013, trupi gjykues vlerësoi se me të drejtë Komisioni, duke vlerësuar çdo të dhënë që vjen nga burime të besueshme e në pajtueshmëri me provat e tjera e duke bërë në çdo rast një vlerësim të tyre sipas bindjes së brendshme, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke mos i deklaruar të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “{***}” ShA për periudhën 2008-2012, në kundërshtim me parashikimet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi

gjykues vlerësoi se kjo pasaktësi në deklaram nuk mund të shërbejë si shkak i veçuar për të prodhuar situatën e vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, por i jep efektet e saj në analizën financiare të kryer për periudhën 2003-2016, në të cilën nuk përfshihen këto të ardhura, në zërin e të ardhurave të përfituara nga marrëdhënia e qirasë së personit të lidhur me shoqërinë “{***}” ShA, për periudhën 2008-2012.

65. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *sa i përket gjykimit dhe dhënies së vendimeve me nr. {***}, datë 28.05.2008, vendimit nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe vendimit nr. {***}, datë 24.03.2014, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk ka konstatuar shkaqe për të cilat duhet të jepte dorëheqjen nga gjykimi i këtyre çështjeve, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk ka konstatuar, gjithashtu, as qëndrime të njëanshme apo favorizuese për shoqërinë “{***}” ShA, trupi gjykues konstatoi se në vendim, Komisioni ka arsyetuar: Përveç sa më sipër, në analizë të marrëdhënies disavjeçare me shoqërinë e sigurimeve “{***}” ShA, në referim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, me ndryshimet përkatëse”, rezulton se subjekti ka shqyrtuar çështjet nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe nr. {***}, datë 24.03.2014, me këtë shoqëri, në një kohë kur personi i lidhur, bashkëshorti i saj, ka përfituar vlera monetare, në llogaritë e tij bankare në “Raiffeisen Bank”, nga shoqëria “{***}” ShA, 3.000.000 lekë, të shtrira në periudhën tetor 2008-nëntor 2014. Subjekti duhet të merrte të gjitha masat e duhura për të evituar situatat e tilla të konfliktit, duke qenë e vetëdijshme se hyrja në fuqi e parashikimeve ligjore nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar e ngarkonte me përgjegjësinë e zbatimit dhe marrjen e masave për shmangien e këtyre situatave. Trupi gjykues vlerëson se vendimet: nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe nr. {***}, datë 24.03.2014, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, e vënë subjektin në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, pasi ajo nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjet, ku pala ndërgjyqëse kishte marrëdhënie juridiko-civile, gjatë gjykimit të çështjeve me bashkëshortin, nga të cilat buronin interesa të përmendura në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005.*
66. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës³³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni sa i përket gjykimit dhe dhënies së vendimeve, ku palë e paditur ka qenë shoqëria “{***}” ShA, vlerësoj se në lidhje me dhënien e vendimit nr. {***}, ku unë kam qenë anëtare e trupit gjykues që ka dhënë vendimin, nuk kam qenë në kushtet e papajtueshmërisë me nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashikon ky nen. Në rastin e dhënies së këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Gjykata e Apelit, mbi ankimin e paditësit, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 12.12.2007, në këtë mënyrë: “Pranimin pjesërisht të padisë, duke u detyruar pala e paditur “{***}” ShA Tiranë, të paguajë në favorin e paditësit S. B., një shumë prej 621.507 lekësh”. Shtoj këtu se bashkëshorti im, për këtë vit, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie kontraktore me subjektin shoqëria e sigurimeve “{***}” ShA. Lidhur me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2013, ku unë kam qenë në cilësinë e relatores së çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 04.05.2011, ka vendosur: “Pushimin e gjykimit të çështjes”. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë”. Me vendimin nr. {***}, datë 19.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: “Kthimin e padisë së bashku me aktet paditësit B. M.”. Mbi ankimin e paditësit,*

³³ Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit për: “Subjekti i rivlerësimit në shqyrtimin e çështjeve për të cilat janë marrë vendimet nr. {***}, datë 28.05.2008; nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe nr. {***}, datë 24.03.2014, ka qenë në një nga rastet e kërkesës për përjashtim, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile”.

*Gjykata e Apelit Shkodër, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 19.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues”. Pra, edhe me këto dy vendime të dhëna nuk konstatoj shkaqe për të cilat unë duhet të jepja dorëheqjen nga gjykimi i këtyre çështjeve dhe nuk konstatoj gjithashtu qëndrime të njëanshme. Të njëjtët argumente e qëndrime, subjekti i rivlerësimit i ka përsëritur edhe në ankim.*

67. Nga analizimi i akteve të hetimit administrativ të kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi se me shkresën nr. {***} prot., datë 05.03.2020, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjet gjyqësore të shqyrtuara nga gjyqtarja Lindita Hoxha, me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShA, përgjatë periudhës 2008-2014. Gjykata e Apelit Shkodër³⁴ ka informuar Komisionin se sipas të dhënave të kërkuara, gjyqtarja ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 28.05.2008, vendimin nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe vendimin nr. {***}, datë 24.03.2014, duke përcjellë dhe vendimet përkatëse, konkretisht:
- vendimi nr. {***}, datë 10.10.2013, i Gjykatës së Apelit Shkodër, me palë paditëse shoqërinë “{***}” ShA dhe palë të paditur z. A. T., me objekt “Kthimin nga ana e të paditurit të shumës prej 10.008 eurosh”. Në këtë vendim, trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryesues, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 04.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër³⁵ dhe rrëzimin e padisë”;
 - vendimi nr. {***}, datë 24.03.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër, me palë paditëse z. B. M. dhe palë të paditur shoqërinë “{***}” ShA, me objekt “Dëmshpërblimin pasuror dhe jopasuror”. Në këtë vendim, trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e anëtares, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 19.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë³⁶ dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues”.
68. Në analizë të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi kontrolloi vendimin e Komisionit, konstatoi se ky i fundit nuk ka arritur në ndonjë konkluzion, lidhur me vendimin nr. {***}, datë 28.05.2008, të Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili të ketë sjellë pasoja juridike, në drejtim të vlerësimit të vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, në shkelje të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit. Trupi gjykues vë re se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, lidhur me vendimin e sipërcituar, është përsëritje e shpjegimeve të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohet gjetjeve fillestare nga hetimi administrativ i Komisionit, gjetje këto për të cilat Komisioni nuk ka konkluduar në vendim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit sa i takon vendimmarrjes në vendimin nr. {***}, datë 28.05.2008, të Gjykatës së Apelit Shkodër, nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me situatën e konfliktit të interesit dhe, si i tillë, nuk mund të ndikojë në shqyrtimin e shkakut të ngritur në ankim për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit.
69. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se nuk ka konstatuar shkaqe për të cilat duhet të jepte dorëheqjen nga gjykimi i çështjeve, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, situatën e konfliktit të interesit e ka arsyetuar e bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

³⁴ Gjykata e Apelit Shkodër ka përcjellë informacionin në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 11.03.2020.

³⁵ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 04.05.2011, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

³⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 04.05.2011, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

70. Trupi gjykues vëren se referuar nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, parashikohet se: *“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisve të tij publike.*

Në mbështetje të parashikimit të nenit 13, pika 2 e këtij ligji, sipas të cilit: *“[...] 2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar”*, trupi gjykues çmoi se dispozitat e zbatueshme në rastin konkret, duhet të ishin ato të paparashikuara në Kodin e Procedurës Civile, konkretisht neni 72 i tij³⁷, i cili parashikon rastet kur një gjyqtar është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje, për të shmangur rastin e një konflikti interesi. Neni 72, pikat 1 dhe 6 e Kodit të Procedurës Civile, parashikojnë: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: “1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; [...] 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie”*. Gjithashtu, trupi gjykues çmon të referojë edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, në të cilin, ndër të tjera, ka arsyetuar: *“[...] Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike [...]*. Po ashtu, në Komentarin e Parimeve të Bangalores, në pikën 52 të tij parashikohet se: *“Paanshmëria është cilësia themelore e kërkuar nga një gjyqtar dhe atributi kryesor i gjyqësorit. Paanshmëria duhet të ekzistojë edhe si çështje faktike edhe si çështje e perceptimit të arsyeshëm. Nëse njëanshmëria perceptohet në mënyrë të arsyeshme, ky perceptim ka të ngjarë të lërë një ndjenjë ankese dhe padrejtësie që është kryer, duke shkatërruar kështu besimin në sistemin gjyqësor. Perceptimi i paanshmërisë matet me standardin e një vëzhguesi të arsyeshëm. Perceptimi se një gjyqtar nuk është i paanshëm mund të lindë në një numër mënyrash, për shembull, nga një konflikt interesi i perceptuar, nga sjellja e gjyqtarit në gjykatë, ose nga lidhjet dhe aktivitetet e tij jashtë gjyqësore [...]”*.

71. Bazuar në parashikimet ligjore të sipërcituara, trupi gjykues vlerësoi se situata në të cilën subjekti i rivlerësimit është gjendur, duke qenë pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 10.10.2013 dhe vendimin nr. {***}, datë 24.03.2014, kur njëra nga palët ka qenë shoqëria “{***}” ShA, me të cilën, në kohën e dhënies së vendimeve, bashkëshorti ka qenë në marrëdhënie qiraje, bazuar në kontratat e qirasë të lidhura përkatësisht, në

³⁷ Në nenin 72, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë; 5. është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”*.

datat 01.01.2013 dhe 01.03.2014, duke përfituar nga kjo marrëdhënie shumë totale prej 680.000 lekësh, është një situatë që meritonte trajtimin, si një nga rastet kur gjyqtari duhet të dorëhiqej nga qenia e anëtarit në një trup gjykues. Subjekti i rivlerësimit ishte i detyruar, për shkak të parashikimeve ligjore, të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve në fjalë, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit, duke qenë se marrëdhëniet që ekzistonte mes tij dhe palëve ndërgjyqëse ishte një marrëdhënie në fuqi, e cila vazhdonte të prodhonte pasoja të ndërsjella mes palëve dhe që përfaqësonte një interes privat për subjektin e rivlerësimit. Për sa më sipër, duke mos e ekspozuar këtë situatë konflikti dhe duke mos u dorëhequr prej gjykimit të çështjes, subjekti e ka vendosur veten në kushtet e nenit 72, pikat 1 e 6 të Kodit të Procedurës Civile, situatë e cila do të ishte e tillë, pavarësisht vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në raport me çështjen. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj.

72. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 64,35 m², në {***}, Lezhë, nga Komisioni nuk është bërë një analizë e qartë e burimeve financiare të deklaruar dhe të përdorura nga subjekti rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie*, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2016 pakësimin e gjendjes cash për pagimin e këstit të parë të apartamentit. Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2016 vlerën e provës, në referim të pikës 5, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile. [...] Trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes cash në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
73. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se:
- i) Komisioni, në vendim, është i paqartë dhe konfuz, pasi nuk ka saktësuar se për cilin këst të detyrimit, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare.
 - ii) në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të paguar këstin e parë të vlerës së apartamentit, ndërsa në vendim, pa ndryshuar asnjë rrethanë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të paguar këstin e parë në shumë 10.000 euro.
 - iii) kursimet në *cash* në masën 1.200.000 lekë janë përdorur tërësisht për pagesën e këstit të parë të apartamentit, duke u zeruar kështu vlera e kursimeve të vitit 2015. Ky shpenzim nuk është deklaruar si pakësim pa ndonjë qëllim, por duke u cilësuar nga subjekti i rivlerësimit si i mjaftueshëm fakti i kryerjes së shpenzimit dhe deklarimit të burimit të krijimit të tyre.
74. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të kontrollit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 64,35 m², në {***}, Lezhë, trupi gjykues konstatoi se z. G. A., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në datën 30.03.2016, në cilësinë e porositësit ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, kontratën e porosisë me objekt ndërtimin e një apartament banimi për çmimin prej 34.500 eurosh. Sipas nenit 3, pika 2 e kësaj kontrate *porositësi ka paguar këstin e parë të blerjes së ambientit që premtohet, në vlerën prej 10.000 euro, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes. PAGESA E KËSTIT TË PARË VËRTETOHET EDHE NGA MANDATARKËTIMI ELEKTRONIK NR. {***}, DATË 30.03.2016, LËSHUAR NGA SHOQËRIA “{***}” SHPK, SIPAS TË CILIT Z. G. A. KA ARKËTUAR SHUMËN 10.000 EURO, PËR PAGESË KËSTI PËR NJË APARTAMENT NË {***}.*

74.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë porosie për blerjen e një apartamenti në {***}, me sipërfaqe 64,35 m², me kursime nga të ardhurat*

*e deklaruar çdo vit, paguar kësti i parë i vlerës prej 10.000 euro, më datë 30.03.2016 (mandatarkëtimi nr. {***}). Vlera: 35.400 euro, shlyer 10.000 euro. Pjesa në %: 50%.*

74.2 Në deklaratën e interesave të vitit 2016, ka deklaruar: *Kontratë porosie për blerjen e një apartamenti në {***}, Lezhë, me sipërfaqe 64,3 m², në vlerën 35.400 euro, me shoqërinë ndërtuese "{***}"*. Vlera: 35.400 euro. Paguar kësti i parë më datë 30.03.2016, në shumën 10.000 euro, nga kursimet gjatë vitit 2015 të deklaruar më parë. Këstet dhe afatet e tjera, sipas pasqyrimin në kontratën, më datë 30.03.2016.

75. Në analizë të pretendimeve e argumenteve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkakun e ankimit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, arsyetimin dhe konkluzionet e tij i ka mbështetur në argumentin e mosdeklarimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të pakësimit të gjendjes së kursimeve në *cash*, në deklarimin e vitit 2016, për pagimin e këstit të parë të apartamentit. Komisioni, në vendim, ka konstatuar dhe ka arritur në përfundimin se: *38.6 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2016 vlerën e provës, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile. [...] 38.10 Trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të germës "b", të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.* Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka saktësuar se për cilin këst të detyrimit subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare është i pabazuar në fakte. Për më tepër, trupi gjykues vëren se pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, i referohen posaçërisht kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit për mungesën e burimeve financiare të ligjshme për pagesën e këstit të parë, çka kundërshton argumentin e saj për paqartësi të arsyetimit të vendimit të Komisionit.
76. Në lidhje me pretendimin se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të paguar këstin e parë të vlerës së apartamentit, ndërsa në vendim, pa ndryshuar asnjë rrethanë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të paguar këstin e parë në shumën 10.000 euro, trupi gjykues vëren se Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ka njohur subjektin e rivlerësimit me gjetjen: *Duket se subjekti ka mundësi të paguajë këstin e parë të apartamentit me kursimet e akumuluar deri në vitin 2015 dhe kursimet deri në mars të vitit 2016.* Në vendim, Komisioni ka arritur në konkluzionin e cituar edhe më sipër në këtë vendim për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë objekt kontrolli, sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, i ka drejtuar pyetje subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjendjen e kursimeve në *cash* të deklaruar në vite e, në këtë kontekst, i ka pasur të qarta qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, ndërsa në vendim ka bërë interpretimin dhe vlerësimin përfundimtar të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me to, si burim për krijimit e pasurisë, vlerësim të cilin trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë, siç arsyetohet në vijim.
77. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka pretenduar se kursimet në *cash* në masën 1.200.000 lekë janë përdorur tërësisht për pagesën e këstit të parë të apartamentit në mars të vitit 2016, duke u zeruar kështu vlera e kursimeve të vitit 2015, por ky shpenzim nuk është deklaruar si pakësim pa ndonjë qëllim, duke u cilësuar si i mjaftueshëm fakti i kryerjes së shpenzimit dhe deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë.

Në analizë të këtij pretendimi, në verifikim të burimit të krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në lidhje me kursimet në *cash*, në deklaratat periodike të interesave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Në vitin 2014: *Kursime në shumën 900.000 lekë ruajtur në cash, ardhur nga puna ime dhe nga dëmshpërblimi i punës së bashkëshortit marrë me vendim gjykatë.*

Në vitin 2015: *Kursime në shumën 1.200.000 lekë në gjendje cash, të cilat rrjedhin nga të ardhurat nga puna ime dhe nga dëmshpërblimi i punës së bashkëshortit marrë me vendim gjykatë.*

78. Në përgjigjet mbi pyetjen e drejtuar nga Komisioni, në pyetësorin drejtuar më datë 08.01.2020, lidhur me blerjen e apartamentit në Lezhë, se: *Na tregoni lidhur me gjendjen e likuiditeteve në vite, duke specifikuar “Gjendje e të hollave familjare cash në shtëpi”, subjekti ka deklaruar se: [...] Kursime të deklaruar për këtë periudhë, mbi të cilat është bërë blerja e apartamentit në {***}, Lezhë, kanë qenë: Për vitin 2014 janë 900.000 lekë kursime, duke përfshirë edhe shumën prej 871.000 lekësh e përfituar nga vendimi gjyqësor si dëmshpërblim për largimin e padrejtë nga puna të bashkëshortit tim. Në këtë vit kemi pasur shumë pak kursime, pasi në këtë vit është shlyer në cash shuma prej 400.000 lekësh të mbetura nga shuma 600.000 lekë shtetasit B. H.. Për vitin 2015, duke përfshirë edhe kursimet e bëra në vitin 2014, janë 1.200.000 lekë dhe i kam përdorur më 30.03.2016, për të paguar këstin e parë në shumën 10.000 euro për blerjen e apartamentit në {***}. Për këtë vit kam kursyer vetëm 300.000 lekë, pasi u kam shlyer familjarëve të bashkëshortit tim vlerën e mbetur të operacionit prej 2.500 eurosh. Për vitin 2016 janë 680.000 lekë kursime, të cilat duke i shtuar edhe pjesën e kursimeve të djalit në shumën 900 euro, të mbledhura nga dhurimet që i janë bërë për ditëlindje në disa vite, shtuar edhe një pjesë të overdraftit, janë përdorur në vitin 2017, për të paguar këstin e dytë prej 8.500 eurosh të apartamentit [...].*

Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe atë të vitit 2015 ka deklaruar, jo shtesa apo pakësime, por gjendjen totale të kursimeve në *cash*, të akumuluar nga viti në vit. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në fund të vitit 2015 kishte të disponueshme kursime në *cash* në shumën totale prej 1.200.000 lekësh.

79. Në analizë të deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2016, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe situatës faktike konkrete, trupi gjykues vëren se sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit të sipërcituar, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht, si dhe burimin e krijimit të saj. Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i krijimit të pagesës për këstin e parë të pasurisë apartament në {***}, Lezhë, në shumën 10.000 euro, janë *kursimet gjatë vitit 2015 të deklaruar më parë*. Në interpretim të këtij deklarimi, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, duke deklaruar burimin e krijimit të pagesës së këstit të parë të pasurisë objekt kontrolli, nga kursimet në *cash* të vitit 2015, ka përmbushur detyrimin për deklarimin e burimeve të krijimit të pagesës prej 10.000 eurosh, si këst i parë i blerjes së pasurisë apartament në {***}, Lezhë.

80. Bazuar në këtë arsyetim, trupi gjykues nuk e gjen të drejtë interpretimin që Komisioni i ka bërë deklarimit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, duke mos e konsideruar si të vlefshëm e, për pasojë, duke mos i dhënë peshë burimit të deklaruar të krijimit të pagesës së këstit të parë, në këtë deklaratë. Trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit, duke deklaruar në vitin 2016 se burimi i krijimit të shumës prej 10.000 eurosh përbëhet nga kursimet e vitit 2015, ka dhënë elementet që identifikojnë përdorimin e kursimeve në *cash*, në kushtet kur këto kursime ishin deklaruar në vitin e mëparshëm, elemente këto të cilat duhet të lexohen e vlerësohen në mënyrë integrale. Duke përcaktuar si të rëndësishme vlerën provuese të deklaratës periodike të vitit 2016, në zbatim të

nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 e duke e konfrontuar dhe gjetur atë të njëjtë me burimin e deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, [kursimet], trupi gjykues vlerësoi se si burim krijimi i kësaj pasurie duhet të konsiderohet ai i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit - *kursimet në cash të deklaruara në vitin 2015*.

81. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të shkakut të ankimit për pasurinë objekt kontrolli, vëren se vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë në pamundësi financiare për të mbuluar me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit është afektuar tërësisht nga moskonsiderimi prej tij i shumës prej 1.200.000 lekësh, i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si gjendje në *cash* në fund të vitit 2015 dhe si burim krijimi për pagesën e sipërcituar, i cili ishte dhe pretendimi thelbësor i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri. Në vijim, në kushtet kur nga arsyetimi i mësipërm u krijua bindja se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në fund të vitit 2015 ka pasur gjendje në kursimet në *cash* shumën prej 1.200.000 lekësh, të cilat janë përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit në {***}, Lezhë, trupi gjykues çmoi se bie konkluzioni i Komisionit mbi pamundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për krijimin me burime të ligjshme të pasurisë objekt kontrolli.
82. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë për pasurinë apartament në {***}, Lezhë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit është i bazuar.
83. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *për pasurinë automjet tip “Benz 270 C Class” konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mundësinë financiare të huadhënësve për të dhënë shumat përkatëse dhe nuk shpjegon mënyrën e marrjes së tyre, në muajin kur është blerë automjeti, është i pabazuar*, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: *Vlera e të ardhurave vjetore të shtetasit R. J., në shtetin përkatës ShBA dhe më pas në Kanada, Toronto, që nga viti 2001, nuk provon mundësinë e këtij të fundit që të japë hua shumën 4.000 USD apo të shtetasit B. J. që të japë hua shumën 1.000 euro dhe nuk shpjegon mënyrën e marrjes së saj, për sa kohë dhe nga sistemi TIMS rezultoi se në muajin kur është blerë makina, ky shtetas nuk ka qenë në Shqipëri. Fakti i transferimit nëpërmjet sistemit bankar të të ardhurave të shtetasit R. J. nuk provon destinacionin final të këtyre të ardhurave dhe nuk shërben si burim për huan. Trupi gjykues, lidhur me destinacionin final të këtyre të ardhurave, transferuar nga shtetasi R. J. gjatë viteve, mban në konsideratë se nga hetimi administrativ rezultoi se me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.02.2015, shtetasi R. J., ka blerë apartament në Shkodër nga shtetasi S. B. në vlerën prej 7.790.100 lekësh. Përveç sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të justifikimit të burimit për dy hua e marra nga vëllezërit dhe nuk ka shpjeguar bindshëm mënyrën e marrjes së huave, shërbyer për blerjen e pasurisë së luajtshme, automjet në vitin 2010. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë objekt hetimi, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
84. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se:
 - i) mundësia financiare e z. B. J., për t’i dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën 1.000 euro, është provuar gjatë hetimit administrativ, duke paraqitur si provë vërtetimin shkollor të tre fëmijëve në {***} në Shkodër, hyrje-daljet e z. J. në sistemin TIMS për shumë vite, pasi ai ka punuar në Mal të Zi, i pasiguruar, si dhe foto të shtëpisë me sipërfaqe 120 m² ku banon z. J. e foto të tokës në pronësi, në fshatin {***}, ku ai banon me familjen;

ii) konkluzioni i Komisionit, lidhur me huan e marrë nga z. R. J., nuk mbështetet në shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Llogaria bankare e z. R. J. është menaxhuar nga prindërit e tij në Shkodër, duke bërë të mundur marrjen e huas nga këta të fundit. Fakti se z. R. J. nuk ka qenë në Shqipëri në kohën kur është blerë makina është një pretendim që nuk ka dalë asnjëherë gjatë hetimit administrativ;

iii) blerja e një apartamenti nga z. R. J., në shumën 7.790.100 lekë, nuk tregon për një pamundësi financiare të tij që të mundësonte dhënien e huas në shumën 4.000 USD, në vitin 2010, aq më tepër që kjo hua është shlyer;

iv) subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit në Komision ka paraqitur si prova pasqyrat e të ardhurave marrë nga sistemi bankar e të sjella nga vetë z. R. J., të cilat tregojnë për të ardhura shumë të mira të tij, në kushtet kur ka qenë emigrant i ligjshëm që nga viti 2001 në SHBA dhe më pas në Toronto, Kanada.

85. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

85.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, ka deklaruar: *Makinë tip Benz 270, C Class, blerë me kontratë në mars 2010, në shumën 5.000 euro, plus 400.000 lekë doganë, me kursime dhe hua të marrë shtetasve B. J. 1.000 euro dhe R. J. 4.000 dollarë. Vlera: 5.000 euro dhe 400.000 lekë. Pjesa në %: 50%. Sa u takon deklaratimeve periodike pranë ILDKPKI-së, lidhur me krijimin e pasurisë automjet tip “Benz 270, C Class”, vihet re se në vitin 2010, subjekti, në rubrikën “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme e të luajtshme”, ka deklaruar: *Makinë tip Benz 270, e blerë pjesërisht me të ardhurat personale, pjesa tjetër me hua cash, 4.000 euro të ardhura personale, 1.000 euro hua. Vlera: 5.000 euro pa doganë, plus 400.000 lekë vlera doganës.*” Ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: *1.000 euro hua pa interes B. A., 4.000 USD hua pa interes R. A..**

85.2 Në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit deklarimin e sipërcituar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e ka shoqëruar me:

i) kontratë shitblerje automjeti, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.04.2010, të lidhur mes z. K. D., në cilësinë e palës shitëse dhe z. G. A., në cilësinë e palës blerëse, me objekt shitblerjen e automjetit të markës “Daimler Chrysler”, tip. {***}, për shumën 5.000 euro;

ii) deklaratë për huamarrje, datë 05.03.2015, e z. R. J., në të cilën deklaroi se i ka dhënë hua vëllait të tij G. A., shumën 4.000 dollarë për të blerë një automjet të ri në vitin 2010, shumë e cila i është shlyer në vitin 2011;

iii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.03.2015, e z. B. J., i cili deklaroi se në vitin 2010 i ka dhënë i ka dhënë hua vëllait të tij G. A., shumën 1.000 euro, shumë të cilën ia ka kthyer në vitin 2011.

Në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar nga Komisioni, më datë 08.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *B. J., vëllai i bashkëshortit tim ka të regjistruar aktivitetin si person fizik “Tregti veshjesh” që në vitin 2011, i njëjti aktivitet që më parë ka qenë i regjistruar në emër të vjehrrit tim Xh. J. dhe sipas vërtetimit të drejtorisë së tatimeve Shkodër, datë 23.01.2020, përcaktohet se ka pasur xhiro si më poshtë: në vitin 2005, xhiro 1.705.000 lekë; në vitin 2006, xhiro 1.705.000 lekë; dhe në vitin 2015, xhiro 652.780 lekë. B. J. realizon të ardhura vjetore edhe nga puna si i vetëpunësuar në shtetin kufitar të Malit të Zi. Kjo gjë vërtetohet me anë të hyrje-daljeve të tij të shpeshta në këtë shtet për vite me radhë, pasi ai nuk figuron si punëtor i regjistruar atje. Fakti që ai ka të ardhura nga puna e tij dhe nga aktiviteti i biznesit për tregtim veshje, vërtetohet edhe me rrethana të tjera siç është regjistrimi dhe mbajtja që nga klasa e parë e në vijim në {***}, në Shkodër, të tre fëmijëve të tij [...]. R. J. jeton e punon që në vitin 2001 fillimisht në Amerikë, Nju*

Jork dhe më pas në Kanada (Toronto). Sipas të dhënave të marra nga sistemi, ai, për vitin 2010, vit në të cilin na ka huazuar shumën 4.000 USD, ka realizuar të ardhura 69.356 dollarë [...].

85.3 Bashkëlidhur përgjigjes së sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit:

(i) formularin e të ardhurave dhe taksave shtetërore për z. R. J. dhe znj. V. S., për vitin 2010 dhe vitin 2015, në shtetin e Nju Jork-ut, ShBA. Në formular janë pasqyruar për vitin 2010: të ardhurat *bruto* në shumën 69.356 dollarë, ndërsa të ardhurat *neto* rezultojnë në vlerën 50.656 dollarë; për vitin 2015: të ardhurat *bruto* në shumën 83.508 dollarë, ndërsa të ardhurat *neto* rezultojnë në vlerën 58.908 dollarë;

(ii) të dhënat e sistemit *TIMS* për z. B. J.;

(iii) vërtetimin nr. {***}, datë 28.01.2020, lëshuar nga shkolla e mesme jopublike “{***}”, sipas të cilit nxënësja E. B. J. ka qenë nxënëse në këtë shkollë, gjatë viteve 2016-2019;

(iv) vërtetimin nr. {***}, datë 28.01.2020, lëshuar nga shkolla e mesme jopublike “{***}”, sipas të cilit nxënësi E. B. J. ndjek mësimet në këtë shkollë, gjatë vitit 2019-2020;

(v) vërtetimin nr. {***}, datë 28.01.2020, lëshuar nga shkolla e mesme jopublike “{***}”, sipas të cilit nxënësi E. B. J. ndjek mësimet në këtë shkollë, gjatë vitit 2019-2020;

(vi) Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e Personit Fizik “B. J.”, me NIPT {***}, fushë veprimtarie “tregtim veshjesh në Shkodër” dhe datë regjistrimi më 17.01.2011;

(vii) shkresë nr. {***} prot., datë 23.01.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, sipas të cilës subjekti Xh. J., me NIPT {***}, sipas deklaratave të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, ka raportuar: për vitin 2005 totali i shitjeve 1.705.000 lekë; për vitin 2006 totali i shitjeve 1.705.066 lekë; për vitin 2009 totali i shitjeve 0 (zero) lekë; për vitin 2010 totali i shitjeve 0 (zero) lekë.

85.4 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *kam provuar para jush se vlera e të ardhurave vjetore të kunatit R. J., në shumën 59.000 dollarë, është më se e mjaftueshme që ai të ketë mundësinë që të japë hua shumën e sipërcituar. Këtu unë nuk kam paraqitur të ardhurat e tij para vitit 2010, që realisht kanë qenë të ardhura të mira, pasi ashtu siç kam deklaruar ai është emigrant në SHBA e më pas në Kanada, Toronto, që nga viti 2001.*

86. Në analizë të sa më sipër, në lidhje me pretendimin se mundësia financiare e z. B. J. për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën 1.000 euro është provuar gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision nuk paraqet të dhëna mbi të ardhurat e përfituara nga z. B. J., në mënyrë që të verifikohet mundësia e tij për t'i dhënë hua shumën prej 1.000 eurosh personit të lidhur, në vitin 2010. Nga të dhënat e evidentuara në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e Personit Fizik “B. J.” rezultoi se aktiviteti tregtar, nga i cili subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se z. J. ka përfituar të ardhura, është regjistruar në organet tatimore në vitin 2011, ndërsa sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 23.01.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, rezultoi se nga aktiviteti tregtar i ushtruar më parë nga babai i z. J., në vitet 2009 dhe 2010, nuk janë përfituar të ardhura. Gjithashtu, fakti i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se z. J. ka punuar si emigrant i pasiguruar në shtetin fqinj, në Malin e Zi, nënkupton se të ardhurat e tij nuk plotësojnë kushtin e të ardhurave të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 1.000 eurosh hua nga z. B. J., për rrjedhojë, kjo shumë nuk duhet të konsiderohet në zërin e të ardhurave, në analizën financiare.

87. Sa i përket huas së marrë nga z. R. J., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se konkluzioni i Komisionit se fakti i transferimit të të ardhurave të shtetasit R. J. nuk provon destinacionin final të tyre dhe, për këtë arsye, nuk shërbejnë si burim për huan është kontradiktor, pasi nga njëra anë vë në dyshim mënyrën e marrjes së kësaj huaje te vëllai i bashkëshortit, z. R. J., duke qenë se ai nuk ka qenë në Shqipëri në muajin e blerjes së automjetit, nga ana tjetër është pranuar se ka shumë transfertat bankare nga ky shtetas. Llogaria bankare e R. J. është menaxhuar nga prindërit e tij në Shkodër, duke bërë të mundur marrjen e huas nga këta të fundit. Fakti se z. R. J. nuk ka qenë në Shqipëri në kohën kur është blerë makina është një pretendim që nuk ka dalë asnjëherë gjatë hetimit administrativ.

Lidhur me pretendimin e shtjelluar si më sipër, trupi gjykues vëren se nga verifikimi i të dhënave të përcjella nga bankat e nivelit të dytë në Komision, konstatohet se z. R. J. nuk ka pasur llogari bankare në asnjë nga këto banka. Në ndryshim nga sa ka konstatuar Komisioni rezultoi se z. R. J. ka kryer një numër të kufizuar transfertash bankare në llogaritë e prindërve të tij pranë “ProCredit Bank”, të cilat datojnë pas vitit 2010, vit në të cilin pretendohet se është dhënë huaja prej 4.000 USD. Shumat e transferuara nga z. J. te prindërit e tij, në vitet 2013 e 2014³⁸ duket se lidhen me faktin e blerjes prej tij të një apartamenti në Shkodër, për të cilën ka autorizuar me anë të një prokure të posaçme babain e tij, z. Xh. J.³⁹. Nga verifikimi i llogarive bankare në monedhën dollarë, të z. Xh. J. e të znj. Xh. J., prindërve të z. R. J., rezultoi se ata kanë kryer personalisht derdhje në *cash* në llogaritë personale në dollarë, në shuma të ndryshme gjatë vitit 2010, por nga këto shuma të derdhura nuk evidentohet nëse janë të ardhura të krijuara prej tyre apo janë shuma të dhëna nga djali i tyre, z. R. J.. Këto rrethana faktike i krijojnë bindjen trupit gjykues se z. Xh. J., në vitin 2010, ka pasur në dispozicion të ardhura të z. R. J., të cilat më pas ia ka dhënë djalit tjetër të tij, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për të blerë automjetin tip “Benz 270, C Class”, në datën 07.04.2010.

88. Në analizë të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se gjatë hetimit në Komision ka paraqitur prova të cilat tregojnë për të ardhura shumë të mira të z. R. J., që mundësonin dhënien e huas në shumën 4.000 dollarë, nga verifikimi i formularit të të ardhurave dhe taksave shtetërore të z. R. J., për vitin 2010, në shtetin e Nju Jork-ut, ShBA, rezultoi se për këtë vit të ardhurat *neto* të përfituara prej tij pas pagesës së taksave janë në shumën 50.656 dollarë. Në kushtet kur pasuria objekt kontrolli është blerë nga personi i lidhur në datën 07.04.2010, si dhe të dhënat lidhur me të ardhurat e z. R. J. janë referuar nga subjekti i rivlerësimit, vetëm për vitin 2010, për të verifikuar mundësinë e huadhënësit, për krijimin me të ardhura të ligjshme të shumës së pretenduar të dhënë hua, në Kolegj u krye analiza financiare, mbi të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës⁴⁰, për periudhën janar - mars 2010, rezultati i së cilës konfirmoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se z. R. J., vetëm me të ardhurat e krijuara gjatë vitit 201, kishte mundësi të krijonte shumën prej 4.000 dollarësh

³⁸ Në llogarinë me nr. {***} në emër të z.Xh. J., në ProCredit Bank, rezulton një veprim i kryer në datën 13.01.2014, me përshkrimin “J. X.R. kalim në llogari kursimi” në vlerën 11.840 dollarë. Në llogarinë me nr. {***} në emër të znj. Xh. J., në ProCredit Bank, në datën 14.01.2013, me përshkrimin “Derdhje Xh. J. emigracioni” ka kaluar vlera 19.000 dollarë. Znj. Xh. J. ka tërhequr nga llogaria e saj, vlerën 43.290 dollarë, në datën 12.09.2014 dhe 55.400 dollarë, në datën 09.01.2015, vlerë kjo e kredituar në datën 06.01.2015 me përshkrimin “Buiyng a house”.

³⁹ Sipas të dhënave të administruara nga Komisioni nga korrespondenca me noterët publikë, konstatohet se noterja Gj. K. ka përcjellë akt shitblerje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.02.2015, të lidhur mes z. S. B., në cilësinë e palës shitëse dhe z. R. J., në cilësinë e palës blerëse, për blerjen e një apartamenti në Shkodër me sipërfaqe 135 m², në çmimin 7.790.100 lekë. Z. R. J. në lidhjen e kësaj kontrate është përfaqësuar nga babai i tij, z. Xh. J., me anë të prokurës së posaçme, në të cilën i ka dhënë babait të tij tagra përfaqësimi vetëm për kryerje veprimesh juridike për blerje pasurish të paluajtshme.

⁴⁰ Referuar tabelës me të dhëna për shpenzimet e jetesë për familjet në pragun e varfërisë, sipas përbërjes familjare me dy persona, për vitin 2010, në shtetin e Nju Jorkut: CPS Historical Poverty Footnotes (census.gov), USA.

dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerësoi se kjo shumë duhet të përfshihet në zërin e të ardhurave në analizën financiare.

89. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për faktin se z. R. J. nuk ka qenë në Shqipëri në kohën kur është blerë makina është një pretendim që nuk ka dalë asnjëherë gjatë hetimit administrativ, nga kontrolli i vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se ky është një nga argumentet e përdorura nga Komisioni, në arsyetimin e vendimit, mbështetur në të dhënat e sistemit *TIMS* për z. R. J., të cilat ndodhen në dosjen e rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni, në Kolegj dhe, për rrjedhojë, i janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, fakt ky që është kundërshtuar nga ai.
90. Nga analiza financiare e kryer mbi konkluzionet e mësipërme, për periudhën 01.01.2010-07.04.2010, rezultoi se subjekti rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të blerë automjetin tip “Benz 270, C Class”, më së paku në shumën 138.810 lekë. Ky rezultat e çoi trupin gjykues në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, edhe për këtë shkak ankimi, është i drejtë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
91. Në vijim të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendime lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016, në të cilën ka konsideruar të padrejtë qëndrimin e Komisionit, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe anëtarët e familjes së saj në periudhën 2011-2016, si dhe vlerat e konsideruara për shpenzime jetese. Nga shqyrtimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit si më sipër referuar, trupi gjykues konstatoi se ato përsërisin qëndrimin e subjektit të rivlerësimit ndaj gjetjeve paraprake të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, gjetje këto për të cilat nuk është konkluduar më tej, në vendim, çka nënkupton se Komisioni i ka vlerësuar e gjetur të drejta shpjegimet e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit, lidhur me analizën financiare për vitet 2003-2016, nuk janë relevante në drejtim të kundërshtimit të konkluzioneve të Komisionit lidhur me kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë.
92. Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit, pasi subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 3.798.297 lekësh. Trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme rezultoi në një nivel të pajustificueshëm, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për këtë kriter vlerësimi, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
93. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se vendimi nr. 289, datë 06.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Lindita Hoxha, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 289, datë 06.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Lindita Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.02.2023.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi – kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, kundër vendimit nr. 289, datë 06.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim i cili ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Shkodër. Bazuar në vlerësimin tonë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kemi votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

Duke pranuar përgjithësisht faktet e renditura në vendimin e shumicës së trupit gjykues, do të ndalemi në ato fakte dhe rrethana të cilat, sipas pakicës, meritojnë një vlerësim të ndryshëm, i cili përcakton edhe qëndrimin tonë për votën kundër.

2. Subjekti i rivlerësimi, znj. Lindita Hoxha, është shkarkuar prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në konkluzionet që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter lidhur me pasuritë e tij dhe të personit të lidhur me të (bashkëshortit), të deklaruara në deklaratën *vetting*. Në gjykimin tonë, problematikat që hasen lidhur me këtë kriter, duhen vlerësuar në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, siç nenet 4, pika 5 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikojnë dhe, nën analizën sipas këtyre parimeve, ato nuk justifikojnë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për sa vijon.
3. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi me sipërfaqe 92 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër”, duke ndjekur rendin e çështjeve të analizuara nga shumica, po vijojmë me vlerësimin e pakicës për secilën prej tyre.

3.1 Lidhur me huan e marrë nga z. S. B.:

3.1.1 Lidhur me njërin prej burimeve të krijimit të pasurisë së cituar më lart, konkretisht huas së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, prej 1.000.000 lekësh, të marrë në vitin 2006 nga personi tjetër i lidhur, z. S. B., por të deklaruar edhe në deklaratat periodike, përkatësisht si burim në vitin 2006 dhe si e shlyer në vitin 2007, duke ndarë të njëjtin qëndrim si shumica, se Komisioni nuk ka qenë në kushtet e pamundësisë për të arritur një konkluzion mbi situatën faktike dhe se duhej t’ia nënshtrohte verifikimit, burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur, kemi vlerësuar në mënyrë të ndryshme të dhënat që janë evidentuar nga fashikulli i hetimit lidhur me të ardhurat e huadhënësit, duke arritur një konkluzion të ndryshëm nga shumica mbi mundësinë e tij për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e shumës së dhënë hua, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

3.1.2 Lidhur me këto burime, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision shkresën nr. {***} prot., datë 23.01.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, sipas së cilës z. S. B. ka ushtruar

aktivitet tregtar i regjistruar si person fizik dhe, në bazë të deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, ka realizuar xhiro vjetore në vitet 2005 dhe 2006, përkatësisht në vlerat 6.400.000 lekë dhe 7.700.000 lekë. Ndodhur në këto rrethana, kemi vlerësuar se Komisioni, por edhe Kolegji, e kishte lehtësisht të përlllogaritshme normën e fitimit të realizuar prej huadhënësit, të paktën për këto vite, duke pasur në konsideratë të dhënat që vijnë nga shkresa e cituar më lart, se personi tjetër i lidhur ka ushtruar aktivitetin si person fizik nën fashën e tatimit të thjeshtuar, si edhe legjislacionin e zbatueshëm për këtë kategori subjektsh tatimore në këto vite.

Në këto kushte, referuar ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, *Për tatimin mbi të ardhurat*”, subjektet tregtare të regjistruara si “persona fizikë”, kanë pasur detyrimin të paguajnë tatimin e thjeshtuar në masën 4% të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik dhe konkretisht, detyrimi tatimor për huadhënësin ka qenë respektivisht 256.000 lekë për vitin 2005 dhe 308.000 lekë për vitin 2006. Nga qarkullimi vjetor i realizuar për të dyja vitet (2005 dhe 2006) në një total prej 14.100.000 lekësh, nëse fitimi do të përlllogaritej minimalisht 20% deri maksimalisht 25% të qarkullimit vjetor sipas jurisprudencës së Kolegjit, ky subjekt tregtar (huadhënësi) ka pasur mundësinë të gjeneronte një fitim nga 2.820.000 lekë deri në 3.525.000 lekë, shifra këto të cilat justifikojnë sipas një vlerësimi të arsyeshëm, dhënien e huas në shumën prej 1.000.000 lekësh, duke konsideruar të ardhurat e ligjshme vetëm të këtyre dy viteve. Gjithashtu, rezulton nga vendimi nr. {***}, datë 06.03.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, se personi tjetër i lidhur ka ushtruar aktivitet tregtar si person fizik, në bar bufe “{***}” që prej vitit 2002, duke u dhënë besueshmëri deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për mundësitë e huadhënësit për justifikimin me burime të ligjshme të krijimit të shumës së dhënë hua edhe nga të ardhura të tjera të siguruar ndër vite.

3.1.3 Qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit pamundësia e qartësimit të situatës faktike lidhur me këtë burim, e ka shmangur atë nga verifikimi i mundësisë për krijimin e shumës prej personit tjetër të lidhur, sipas mendimit tonë, nuk mund të jetë një shkak që duhet të rëndojë subjektin e rivlerësimit. Hetimi dhe vlerësimi i Komisionit duhet të kishte qenë më i plotë në drejtim të kontrollit të burimeve, duke verifikuar edhe gjendjen familjare të personit tjetër të lidhur, qoftë edhe nëpërmjet aksesit të drejtpërdrejtë mbi bazën e të dhënave zyrtare të regjistrit të gjendjes civile, sipas parashikimit të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim kryerjen e një përlllogaritjeje objektive të shpenzimeve për jetesë, sipas një standardi të vendosur tashmë prej Kolegjit. Pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, në këtë proces ka barrën e provës për të provuar deklaratimet e saj, Komisioni, si institucioni që zhvillon hetimin, duhet të ndërveprojë me subjektin e rivlerësimit gjatë hetimit dhe ta qartësojë atë për çështjet që ai duhet të provojë sipas vlerësimit të Komisionit, aq më tepër kur bëhet fjalë për të dhëna të cilat kërkohen për shkak të standardeve të mbajtura nga institucionet e rivlerësimit, dhe jo për shkak të ndonjë parashikimi ligjor që udhëzon qartësisht subjektet drejt provueshmërisë së disa fakteve. Në vlerësimin e pakicës, Komisioni mundej dhe duhej të kishte analizuar mundësinë e krijimit të shumës prej 1.000.000 lekësh nga personi tjetër i lidhur, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe fakti që ai ka munguar të bëjë këtë verifikim, nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit tej kufijve të barrës së provës që i ka kaluar atij.

3.1.4 Për sa më lart, vlerësimi që i bëhet mundësisë së personit tjetër të lidhur për të justifikuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua, është i mbështetur mbi një vlerësim logjik të situatës faktike objektive të përshkruar më lart dhe që lidhet me qëndrimin e Komisionit, si edhe me faktet e konstatuara mbi aktivitetin tregtar të huadhënësit, që duket se ka qenë i qëndrueshëm dhe me një qarkullim të lartë të të ardhurave në vitet për të cilat ka të dhëna, që sugjerojnë për të ardhura të kënaqshme edhe në vitet e tjera, elemente që bëjnë të besueshme si mundësinë për krijimin e shumës prej 1.000.000 lekësh, por edhe huadhënien në vetvete si marrëdhënie.

3.1.5 Për këto arsye, pakica ka arritur në konkluzionin e ndryshëm nga shumica, se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, duhet të konsiderohet se e kalon testin e besueshmërisë për mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. S. B., për t'i dhënë asaj shumën prej 1.000.000 lekësh, të përdorur si një nga burimet për krijimin e pasurisë apartament, ku subjekti banon edhe aktualisht, dhe kjo shumë duhet konsideruar si një burim i ligjshëm i kësaj pasurie.

3.2 *Lidhur me kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit si burim krijimi:*

3.2.1 Rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* se një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament, të blerë në vitin 2006, janë edhe paratë e kursyera, duke shpjeguar në vijim se flitet për përdorimin e gjendjes *cash* të deklaruar si kursim i subjektit në deklaratat periodike të viteve 2004 dhe 2005, në vlerën totale prej 700.000 lekësh.

Lidhur me këtë burim, anëtari i kësaj pakice, gjyqtari Sokol Çomo, i është bashkuar qëndrimit të shumicës dhe, për rrjedhojë, në vijim, lidhur me përdorimin e kursimeve në gjendje *cash*, si burim krijimi i kësaj pasurie, paraqitet vetëm qëndrimi i gjyqtarës Ina Rama.

3.2.2 Komisioni, por edhe shumica e trupit gjykues, nuk i ka konsideruar këto të ardhura si një burim për krijimin e pasurisë, duke qenë se në deklaratat periodike, subjekti jo vetëm që nuk ka deklaruar pakësime të kësaj gjendjeje, por ka deklaruar se: *pasuritë e tjera të paluajtshme dhe të luajtshme kanë mbetur të pandryshuara (në vitin 2005)/ si në deklarinimin e mëparshëm (në vitin 2006).*

3.2.3 Kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica për trajtimin/leximin e këtyre deklarimeve. Sipas këtij vlerësimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, ka deklaruar saktë dhe plotësisht në deklaratën *vetting*, burimet e krijimit të pasurisë së saj apartament, duke përcaktuar si një prej burimeve të cilat duhej të verifikoheshin, edhe paratë e kursyera deri në momentin e blerjes së pasurisë, në datën 31.07.2006. Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se deri në fund të vitit 2005, subjekti ka deklaruar se ka kursime në vlerën totale prej 700.000 lekësh. Sipas verifikimeve të kryera nga Kolegji, ka rezultuar se subjekti kishte mundësi financiare t'i realizonte këto kursime deri në këtë datë.

3.2.4 Në mungesë të deklarimit të asnjë prej burimeve të krijimit të pasurisë apartament në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti ka kryer një deklarinim të plotë të tyre në deklaratën *vetting*, e cila është objekt kontrolli dhe verifikimi i organeve të rivlerësimit sipas parashikimit të neneve 31 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, subjekti ka zbatuar një urdhërim të ligjit për të deklaruar me saktësi dhe plotësi burimet e krijimit të pasurisë, si edhe ka ndrequr një

deklarim të pasaktë të kryer në deklaratën periodike të vitit 2006, në të cilën nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

3.2.5 Në zbatim të dispozitave ligjore, detyra e organeve të rivlerësimit në këto rrethana, është të verifikojnë nëse deklarimet e subjektit janë të vërteta dhe nëse ai ka burime të ligjshme për të financuar krijimin e pasurisë.

3.2.6 Në drejtim të verifikimit të besueshmërisë së deklarimit se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, ka përdorur kursimet e saj në vlerën 700.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së vitit 2005, kam vlerësuar se duhet të konsiderohen disa elemente. Së pari, se këto kursime janë deklaruar prej saj deri në këtë vit dhe nuk janë përdorur më pas në asnjë prej viteve në vijim si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo justifikimin e ndonjë shpenzimi; së dyti, natyrshëm këto kursime janë përdorur për krijimin e një pasurie bazike, të nevojshme për jetesë, për të cilën subjekti deklaroi si burim, krahas kursimeve, edhe huan e marrë prej personit tjetër të lidhur, por edhe vlerën e overdraftit të tërhequr nga banka. Parë nën këtë optikë, mungesa e deklarimit se janë pakësuar kursimet e krijuara deri në momentin e blerjes së pasurisë, është e besueshme që është një pasaktësi, siç është pasaktësi edhe mungesa e deklarimit të përdorimit të huas si një burim krijimi, në një kohë që ajo e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005, si një veprim juridik që ka ndodhur pikërisht këtë vit. Leximi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e tyre, bëhet në kontekst të disa rrethanave specifike që shoqërojnë rastin konkret, si më poshtë, si dhe duke marrë edhe vlerën e tyre provuese në harmoni me çdo provë apo indicie tjetër që ka rezultuar gjatë hetimit.

3.2.7 Deklarimet e subjektit në vitet 2005 dhe 2006, se pasuritë e tjera të paluajtshme dhe të luajtshme janë pa ndryshime, duke nënkuptuar, sipas shumicës, se në to përfshihen edhe kursimet në para, mendoj se duhen lexuar në raport me të gjitha deklarimet e tjera të subjektit në këto vite. Në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar se ka në posedim, një shtëpi banimi me sipërfaqe 54 m² në pronësi të bashkëshortit, të blerë në vitin 2001, para martese, pasuri të rideklaruar edhe në DPV-në e vitit 2004. Në DPV-në e vitit 2004, ka deklaruar edhe bashkëpronësinë e një automjeti të blerë në muajin shkurt 2005, me vlerë 250.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se ka shtuar të hollat e kursyera *cash* në banesë dhe ka deklaruar gjithashtu se: *pasuritë e tjera të paluajtshme e të luajtshme të deklaruara më parë, kanë mbetur të pandryshuara*. Në DPV-në e vitit 2006, pasi ka deklaruar shtesën e pasurisë apartament, të blerë këtë vit, ka bërë të njëjtin deklaram se: *pasuritë e tjera të luajtshme dhe të paluajtshme kanë mbetur si në deklarinimin e mëparshëm*, duke krijuar një tablo për mënyrën e deklarimit, sipas së cilës duket se në konceptin e pasurive të luajtshme, ajo nuk përfshin likuiditetet në *cash*, të cilat i trajton veçmas tyre. Të njëjtin koncept duket se subjekti e reflekton edhe në deklarimet që ajo ka bërë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën gjendjen e *cash*-it i ka deklaruar te rubrika e të ardhurave dhe jo te rubrika e pasurive.

3.2.8 Kjo panoramë e pasurive të subjektit në këto vite, i jep kuptim dhe besueshmëri deklarimit që ai bën në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe shpjegimeve të dhëna gjatë procesit në Komision, se kursimet e krijuara deri në vitin 2005, prej 700.000 lekësh, janë përdorur si burim për krijimin e pasurisë apartament, duke mbetur të pandryshuara pasuritë e tjera të subjektit. Konstatohet se

subjekti i rivlerësimi deklaroi sërish kursime nga të ardhurat në deklaratën periodike të vitit 2012, duke u shprehur: *Gjendje parash në kesh, kursime nga të ardhurat e përbashkëta; 370.000 lekë*, deklarim i cili konfirmon gjendjen zero të këtyre kursimeve para këtij viti, dhe krijimin e tyre si gjendje vetëm me të ardhurat e vitit 2012. Ky element potencon bindjen se kursimet e mëparshme të akumuluarra deri në fund të vitit 2005, ishin shpenzuar për krijimin e pasurisë apartament.

3.2.9 Këtij arsyetimi i shkon edhe argumenti se duke konsideruar kohën e deklaramit dhe kulturën e subjekteve në plotësimin e deklaratave në ato vite, duket jorealiste që në termin “pasuri e luajtshme”, sipas konceptit të Kodit Civil, subjektet të nënkuptonin gjendjen e likuiditeteve *cash* të ndodhura në banesë, përderisa vërehen përgjithësisht në deklarimet e kësaj periudhe, pasaktësi e gabime që i përkasin qoftë aspektit formal, por edhe atij përmbajtësor të deklaramit. Në këtë kuptim, në vlerësimin tim, deklarimet e subjektit do të duhej të lexoheshin në harmoni me rrethanat e faktit, por edhe me kontekstin e krijuar nga formularët model deklarimi, të cilët pasurinë likuiditet *cash* e përkufizonin si një lloj i veçantë, ndërsa pasuritë e luajtshme, për qëllime deklarimi, identifikoheshin ato të regjistruara në regjistrat publikë.

3.2.10 Për sa më lart, kam vlerësuar se edhe kjo vlerë duhet të përfshihet në burimet e krijimit të pasurisë apartament dhe, në përmbledhje të qëndrimit edhe për burimin tjetër, që është ai i huas, rezulton se mungesa e burimeve të ligjshme për këtë pasuri, të jetë në vlerën 270.000 lekë, që përfaqëson vlerën e munguar, të marrë prej subjektit nga overdrafti, 20 (njëzet) ditë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë.

4. Lidhur me objektin informal të ndërtuar në fshatin Shtoj i Vjetër, ne, gjyqtarët në pakicë, kemi ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica, për sa i përket vlerës/kostos së këtij ndërtimi, vlerësim i cili ka afektuar edhe qëndrimin lidhur me analizën e burimeve të ligjshme të përdorura për financimin e kësaj pasurie.

4.1 Lidhur me këtë objekt, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vlerë të shpenzuar për ndërtimin e tij, shumën prej 1.400.000 lekësh. Në kushtet e një ndërtimi informal, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për shpenzimet e kryera për ndërtimin e tij, duke shpjeguar përgjatë hetimit se ai është ndërtuar nga bashkëshorti, i ndihmuar edhe nga të afërm dhe familjarë të tij, duke përdorur mallra me cilësi të dobët. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ndërtimi nuk mund të konsiderohet si një ndërtim dykatësh, siç Komisioni e ka konsideruar për përlogaritjen e koston, dhe ka përcjellë në Komision foto të këtij objekti, në funksion të provueshmërisë së vlerës së shpenzimeve për të, sipas pretendimeve të subjektit. Gjithashtu, ka paraqitur pas rezultateve të hetimit, edhe një preventiv të hartuar nga inxhinier M. H., sipas të cilit vlera totale e punimeve të ndërtimit të objektit është 1.462.408 lekë.

4.2 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni, në mungesë të paraqitjes së dokumentacionit që provon koston e ndërtimit të saj, ka përdorur për llogaritjen e kësaj vlere, çmimet referuese të EKB-së, të përcaktuara në udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, nga EKB-ja (i vlefshëm edhe për vitin 2012), sipas të cilave ka rezultuar se vlera e shpenzuar për ndërtimin e këtij objekti, do të ishte përafërsisht 6.000.000 lekë. Në funksion të kësaj vlere, Komisioni ka kryer vlerësimin e kësaj pasurie dhe ka konkluduar se ka mungesë të burimeve të ligjshme për ndërtimin e saj, pa përcaktuar një vlerë të

balancës negative, por duke mbajtur vetëm qëndrim ligjor për çështjet e marra në analizë, koston dhe burimet. Përveç këtij arsytimi, rezulton se Komisioni ka konsideruar në arsyetimin e tij⁴¹, si një vlerësim alternativ garantist të vlerës së ndërtimit, në konsideratë të shpjegimeve të subjektit, edhe vlerën e deklaruar prej saj, prej 1.400.000 lekësh, duke arsyetuar se edhe sikur të pranohej kjo vlerë, përsëri subjekti do të kishte rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie.

4.3 Pikërisht mbi këtë logjikë dhe linjë arsytimi, kemi vlerësuar kundërshtimet e subjektit rreth përcaktimit dhe llogaritjes së vlerës së objektit, duke përdorur çmimet e EKB-së, dhe kemi çmuar se në rrethanat që vlera e përcaktuar prej Komisionit nuk i përgjigjet dukshëm realitetit, alternativa e vetme e cila është trajtuar prej Komisionit si një vlerë e mundshme e ndërtimit, është ajo e deklaruar prej subjektit, dhe mbi të duhet të ndërtohet edhe analiza e verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

4.4 Kemi arritur në këtë konkluzion, duke pasur parasysh argumentet si më poshtë vijojnë.

4.4.1 Ndërtimi informal i cili është objekt vlerësimi, dukshëm, nga përshkrimi i subjektit dhe i punonjësve të ALUIZNIT, por dhe nga analizimi dhe vlerësimi i pamjeve në fotografitë që i janë bashkëlidhur praktikës së legalizimit, është një objekt, jo banesë, dhe është ndërtuar në një zonë që duket se nuk ka destinacion banimi, por ka regjimin juridik të tokës bujqësore. Ky objekt jo vetëm që përshkruhet si “jo banesë” në dokumentacionin e praktikës së legalizimit, por as nuk rezulton të jetë përdorur ndonjëherë si i tillë, duke qenë se është ndërtuar për një përdorim krejt të ndryshëm nga banimi, siç është ai i mbarështimit të shpendëve.

4.4.2 Referuar qëllimit për të cilin është ndërtuar objekti, nisur nga përshkrimi në aktet e çështjes, por veçanërisht nga pamjet fotografike të analizuara, rezulton të jetë një objekt i papërfunduar, me konstruksion dukshëm larg standardit që kanë ndërtimet në të cilat referon EKB-ja për çmimet për m².

4.4.3 Kati përdhe i objektit, duket se nuk ka funksion përdorimi, por kryesisht mbajtës, i pajisur me kolona që shërbejnë si mbështetje për katin e parë të objektit. Nga pamjet, konstatohet se, për shkak të prezencës së ujit në dyshemenë e katin mbajtës, duket e vështirë që ky kat, në këtë gjendje, të ketë ndonjë funksion tjetër, veç atij të mbajtjes së shpendëve për rritje. Nga analiza e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, por edhe të dhënave që vijnë nga dokumentacioni në dosje, ky kat i objektit nuk mund të jetë veçse për shpendët dhe jo për qeniet njerëzore.

4.4.4 Kati i parë i objektit ka një strukturë betoni të mbuluar me eternit, një standard krejt i ndryshëm edhe ky nga ai i banesave për ndërtimin e të cilave referon EKB-ja, çmimet që ka përdorur Komisioni.

4.4.5 Çmimet e përcaktuara nga EKB-ja si çmime referuese, u përkasin banesave të ndërtuara në vitin 2013 në qytetin e Shkodrës, duke respektuar standardet e miratuara të ndërtimit dhe, në çdo

⁴¹ *Shih paragrafin nr. 35.15, në faqen 11 të vendimit të Komisionit, objekt kontrolli.*

rast, pasqyrojnë koston e një objekti të përfunduar, në funksion të përdorimit për banim prej qytetarëve.

4.4.6 Përdorimi i çmimeve të EKB-së, është bërë nga Komisioni dhe nga Kolegji për të përcaktuar kostot e ndërtimeve informale sa herë që ato nuk mund të provoheshin me dokumentacion ligjor të paraqitur prej subjekteve, por gjithmonë u janë referuar objekteve informale që janë banesa, siç edhe vetë VKM nr. 198, datë 04.05.1993, “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, si një akt nënligjor kuadër, përcakton. Përdorimi me të njëjtin standard i këtyre çmimeve në objektin në analizë, në vlerësimin e pakicës, është i padrejtë dhe nuk i përgjigjet hapur realitetit, duke ngarkuar në mënyrë joproporcionale subjektin e rivlerësimit, me një shpenzim që dukshëm tejkalon atë që ai realisht ka bërë për ndërtimin e tij.

4.4.7 Në rrethana të tilla të veçanta dhe në mungesë të referencave ligjore për ndërtime të këtij lloji, siç është rasti objekt shqyrtimi, Komisioni duhet të përdorte të tjera mjete ligjore për të përcaktuar vlerën e ndërtimit të tij, në kushtet kur subjekti, për shkak të natyrës informale të ndërtimit, ka qenë në pamundësi të provojë vlerën e saktë të shpenzuar.

4.4.8 Përveç sa më sipër, nuk jemi dakordësuar as me vlerën e përlllogaritur prej shumicës si kosto e ndërtimit, duke e trajtuar objektin si në fazën e karabinasë. Nuk kemi ndarë të njëjtin vlerësim *së pari*, sepse nuk rezulton se ky objekt gjendet në këtë fazë ndërtimore, *së dyti*, sepse vlera e koston, e përlllogaritur mbi këtë përqindje, nuk i referohet ndonjë akti ligjor apo nënligjor dhe në çdo rast që është përdorur nga Kolegji si një version garantist, ka qenë në përgjigje të një pretendimi të vetë subjektit të rivlerësimit dhe *së treti*, sepse subjekti i rivlerësimit nuk është përballuar dhe as është mbrojtur e dëgjuar në Komision për një vlerë të tillë apo, për një qëndrim të tillë ligjor, duke e bërë të pamundur në vlerësimin tonë, aplikimin rishtas në Kolegji të një përlllogaritjeje të koston mbi këtë logjikë.

4.4.9 Bazuar në argumentet e mësipërme dhe duke pasur bindjen se ndërtimi informal nuk ka një kosto të ndërtimit sa ajo e përcaktuar prej Komisionit, kemi konsideruar si të pranueshme alternativën tjetër të koston që vetë Komisioni ka përdorur për analizën e burimeve, që është ajo sa vlera e deklaruar prej vetë subjektit.

4.4.10 Në arsyetimin e tij, Komisioni nuk e ka përjashtuar këtë vlerë si të mundshme për të përfaqësuar koston e ndërtimit, por e ka konsideruar atë si një alternativë garantiste, në pamundësinë e përcaktimit të vlerës së saktë. Për këto arsye, duke konsideruar të padrejtë dhe të pambështetur vlerën e ndërtimit sipas çmimeve të përdorura nga EKB-ja, e vetmja vlerë për të cilën subjekti është mbrojtur dhe dëgjuar gjatë hetimit administrativ, është ajo e deklaruar prej vetë atij në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2013, kur është ndërtuar objekti.

4.4.11 Për të gjitha sa u përmendën më sipër, në analizën që u bëhet burimeve të ligjshme të ndërtimit të këtij objekti, kemi konsideruar si vlerë të shpenzuar për ndërtimin e tij, vlerën prej 1.400.000 lekësh.

4.4.12 Duke ndarë të njëjtin qëndrim lidhur me analizën e burimeve të deklaruara si shumica e trupit gjykues, mungesa e burimeve financiare për subjektin, referuar kësaj pasurie, sipas analizës më sipër, për pakicën rezulton të jetë 864.473 lekë.

5. Lidhur me situatën e konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShA, kemi ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues për sa i përket konkluzionit se subjekti duhej të kishte marrë masat e duhura dhe të kërkonte dorëheqjen e saj prej trupave gjykues në të dyja çështjet që ai ka gjykuar me palë ndërgjyqjese këtë shoqëri, me të cilën bashkëshorti ishte në një marrëdhënie qiraje, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit dhe të çdo paragjykimi rreth paanësisë dhe objektivitetit të tij në gjykim. Ndonëse ndajmë të njëjtin qëndrim si më lart, kemi një vlerësim të posaçëm rreth peshës së kësaj situate në kontekstin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në të cilën është vendosur prej Komisionit dhe është trajtuar edhe prej Kolegjit kjo çështje.

5.1 Konstatohet se nuk provohet asnjë element që tregon se nëpërmjet marrjes së këtyre vendimeve, subjekti i rivlerësimit të ketë tërhequr përfitime pasurore prej shoqërisë “{***}” ShA, për faktin se të dyja vendimmarrjet e tij rezultojnë, nga një analizë e thjeshtë, të kenë shkuar në kundërshtim të interesave financiarë të shoqërisë, madje ato rezultojnë të jenë rënduese në raport me vendimet e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për sa u përket këtyre interesave.

5.1.1 Konkretisht, sipas vendimit nr. {***}, datë 10.10.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër, me palë paditëse shoqërinë “{***}” ShA dhe palë të paditur z. A. T., me objekt “Kthimin nga ana e të paditurit të shumës prej 10.008 eurosh”, trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, në cilësinë e kryesueses, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 04.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e padisë”, ndërsa vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ishte shprehur për pushimin e gjykimit të çështjes. Mënyra e disponimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, me kryesuese subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, për rrëzimin e padisë, ka shuar në mënyrë përfundimtare dhe ka lënë pa mbrojtje gjyqësore shoqërinë “{***}” ShA, përkundrejt interesave të saj në konflikt, në ndryshim nga disponimi për pushimin e gjykimit, i cili i jep fund procesit gjyqësor pa i dhënë një zgjidhje përfundimtare çështjes, pra nuk shuan në themel të drejtat e pretenduara.

5.1.2 Lidhur me vendimin nr. {***}, datë 24.03.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër, me palë paditëse z. B. M. dhe palë të paditur shoqërinë “{***}” ShA, me objekt: “Dëmshpërblimin pasuror dhe jopasuror”, konstatohet se në këtë vendim, trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, në cilësinë e anëtares, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 19.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues”, ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë kishte vendosur kthimin e akteve palës paditëse, në zbatim të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e Apelit Shkodër ka arsyetuar në vendimin e saj, se gjykata e shkallës së parë ka interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe nuk ka kryer një hetim të plotë të çështjes, duke vendosur se kjo çështje duhej rigjykuar, duke i hapur rrugë në këtë mënyrë procesit gjyqësor në shkallë të parë, në kundërshtim me interesat e palës së paditur, shoqërisë

“{***}” ShA, interesat e së cilës konvergjin me mbylljen e shqyrtimin gjyqësor për një pretendim pasuror të ngritur ndaj saj.

5.1.3 Në këto kushte, ndonëse vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, duhej të kishte ndërmarrë veprime për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes për të shmangur çdo dyshim mbi drejtësinë që jo vetëm jepet, por edhe duhet të duket, vlerësohet se praktikisht interesat pasurorë të saj dhe të personit të lidhur me të nga marrëdhënia e qirasë, nuk kanë ndikuar në dhënien e drejtësisë dhe nuk kanë favorizuar shoqërinë “{***}” ShA, situatë e cila duhet konsideruar në këtë optikë në vlerësim tërësor të çështjes.

6. Lidhur me pasurinë automjet, tip “Benz 270 C Class”, kemi ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica lidhur me vlerësimin e mundësisë së personit tjetër të lidhur, z. B. J., për t’i dhënë bashkëshortit të subjektit hua, shumë prej 1000 eurosh. Ndonëse në kuptimin formal, duket se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, nuk paraqiti prova që tregojnë krijimin e të ardhurave të ligjshme për vëllain e bashkëshortit të saj, për krijimin e shumës prej 1000 eurosh, rrethanë që duket se nuk përmbush kriterin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tonë si pakicë, kjo vlerë, për peshën që ka, meriton një vlerësim të ndryshëm nën frymën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, i cili nuk justifikon përdorimin e standardeve të zakonshme të procesit të rivlerësimit për kontrollin e burimeve të ligjshme të pasurive të personave të tjerë të lidhur. Në këto kushte, duke konsideruar edhe të dhënat për shpenzimet e kryera nga huadhënësi dhe marrëdhënien e posaçme mes tij dhe personit të lidhur, kemi vlerësuar si objektivisht të mundshme, krijimin me burime të ligjshme të kësaj shume dhe përfshirjen e saj në analizën financiare për kontrollin e burimeve të krijimit të pasurisë automjet.
7. Në përfundim, duke u shprehur dakord me qëndrimet e tjera të mbajtura nga shumica, kemi vlerësuar se mungesa e burimeve të ligjshme që i korrespondon krijimit të pasurisë apartament, të ndodhur në Shkodër, dhe ndërtimit informal, të ndodhur në {***}, në total, në cilindo version të arsyetuar në këtë mendim, ndonëse e vë subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, nuk duhet konsideruar si një shumë që e vë subjektin në kushtet e mosprovimit bindshëm të burimeve të pasurive sipas konceptit kushtetues të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as të një deklarimi të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, shkarkimi i tij nga detyra nuk gjendet i drejtë.

Pakica ka vlerësuar se pesha e kësaj difference duhet vlerësuar në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, edhe në raport me qëndrimet e tjera të mbajtura nga Kolegji në raste të mëparshme, duke qenë se *së pari*, ajo u atribuohet dy pasurive modeste të subjektit të rivlerësimit, të cilat dëshmojnë për një sjellje të subjektit për të realizuar nevojat bazike të familjes së tij për strehim dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës. Qoftë zgjedhja për banim e një apartamenti me sipërfaqe të vogël, ndërtim i periudhës para viteve ‘90, apo zgjedhja për të ndërtuar një objekt me qëllim ndihmesën e ekonomisë familjare, në një zonë të largët nga qyteti dhe të gjendur vazhdimisht nën përmbytjet natyrore, tregon për një orientim të subjektit drejt ndërtimit të një jetese të thjeshtë dhe larg ndikimit prej funksioneve që ai ushtron. Gjithashtu, fakti që pesha më e madhe e kësaj balance negative vjen për shkak të faktit se është konsideruar e pajustificuar

me burime të ligjshme, huaja e dhënë nga shtetasi B. H., prej 600.000 lekësh, për ndërtimin e objektit në {***}, dhe se ky konkluzion ka ardhur si pasojë e mungesës së provueshmërisë së të ardhurave të ligjshme të familjes së personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit, e cila ndonëse konfirmohet si e tillë për shkak të parashikimeve të ligjit dhe jurisprudencës së Kolegjit, ka një peshë të relativizuar në drejtim të konsiderimit të saj si një shkak shkarkimi.

8. Këtyre konkluzioneve u shtohet edhe arsyetimi i mësipërm rreth konfliktit të interesit, i cili për shkak të rrethanave të faktit, nuk vlerësohet se mund të ngrihet së bashku me balancën negative në nivelin e shkaqeve të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit.
9. Për të gjitha sa arsyetua më lart, kemi votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi